



PROCESVERBAL

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 3 (tretë) të rregullt për vitin 2026, të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi:	Suharekë
Zyra:	Salla e Kuvendit të Komunës
Data:	27.02.2026
Ora:	10:00

Prezentë në takim:

Znj. Sanie Kuçi
Rexhepaj

Z. Flamur Bytyçi

Znj. Doruntina Zenelaj

Z. Urim Suka

Z. Astrit Salihu

Z. Nexhat Ramadani

Znj. Vlorë Kryeziu

Znj. Dafina Kolgeci

Z. Bexhet Kuçi

Znj. Albulena Kokollari

Z. Edon Sadikaj

Z. Aziz Bytyçi

Znj. Mimoza Bajraktari

Z. Enver Shabani

Znj. Besa Kuçi

Z. Syl Zenelaj

Z. Ilir Voci

Z. Dardan Berisha

Z. Labinot Halitjaha

Z. Demokrat Vataj

Znj. Merita Basha

Znj. Antigona Zyba

Z. Liridon Fandaj

Z. Qëndrim Elshani

Znj. Laureta Tafaj

Znj. Jehona Rrafshi

Lumi

Të pranishëm tjerë:

Kryetari i Komunës

Media dhe qytetarë

OSCE, LMT, KDI

Znj. Habibe Bytyqi

Z. Xheladin Sadikaj

Takimin e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z.Bexhet Kuçi,i cili i njoftoi me rendin e ditës.

REND DITE

1. Dhënia e deklaratës së betimit e anëtarëve që janë zëvendësuar;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB);
4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit të komisionit për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;
5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;
6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave;
7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale „Stacioni i Autobusave“ ;
8. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale „Eko Regjionin“ ;
9. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet;
10. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit financiar të ekzekutimit dhe administrimit të buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-dhjetor 2025;
11. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit të komisionit për mbikqyrjen e kontratave në zonën industriale në Shirokë;
12. Pyetje dhe përgjigje;

Urim Suka - kërkoj në emër të grupit të LDK-së që të futet një pikë shtesë në rend dite për me formu një komision prej të gjitha partive ku do të marrin pjesë secila parti me nga një anëtar.Komisioni ka të bëjë me mbikqyrjen e investimeve kapitale që janë bërë në vitin 2025.

Dardan Berisha - realisht ne nuk e kemi asnjë dokument dhe në emër të grupit të PDK-së ne jemi kundër këtij formimi të komisionit sepse kjo vjen ndërhyrje drejtë-përdrejtë në ekzekutiv.Ne kemi drejtorin eShërbimeve Publike i cili ka me menaxhu punë dhe të njejtën kohë e kemi pikën pyetje dhe përgjigje ku mund të bëni pyetje të cilat ju interesojnë juve.

Urim Suka - është detyrë dhe mandat i kuvendit të komunës me mbikqyr punën e ekzekutivit.Ligji për vetqeverisje lokale për veç se i ka dy komisione të përhershme që duhet të bëhen,aty thuhet që në bazë të ligjit mund të formohen edhe komisione tjera sipas nevojës që e sheh kuendi.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën shtesë të grupit të LDK-së.

11 për,11 kundër,1 apstenim

Kryesuesi e përdor të drejtën e votës së dyfishtë dhe voton kundër.

Nuk Miratohet pika shtesë

Kryesuesi - e hedhë në votim rendin e ditës.

16 për,8 apstenime,Miratohet rendi i ditës

Pika 1. Dhënia e deklaratës së betimit e anëtarëve që janë zëvendësuar;

Anëtarët e zëvendësuar të Asamblesë z.Illir Voci, z.Syl Zenelaj dhe z.Demokrat Vataj japin deklaratën e betimit para Asamblesë.

Pika 2.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kalaur;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet pika 1

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB);

Kryesuesi - elaboron pikën dhe hap debatin.

Flamur Bytyçi - në këtë vendim po e shoh që është edhe një përfaqësues i shqiptarëve. Nuk e kam fjalën konkretisht për emër por për procedurën. Si është zgjedh përfaqësuesi i shqiptarëve në këtë komision dhe te pjesa e OJQ-së dhe te mediat?

Avni Bytyçi - siç e tha edhe Kryesuesi, KKSB duhet të themlohet për çdo manadat që bëhet. Ne sipas ligjit për policinë e Kosovës dhe udhëzimit administrativ të MPAL-së dhe MPB i kemi ndjek të gjitha procedurat për themelimin e këshillit. Një pjesë e këtij këshilli shkon me automatizëm ndërsa pjesa tjetër që kërkohet sipas udhëzimit administrativ Kryetari i komunës në afatin e paraparë ligjor ka bërë thirrje publike dhe në bazë të thirrjeve publike dhe propozimeve që janë delegu te zyra e Kryetarit, ne e kemi bërë edhe plotësimimin dhe rangimin e anëtarëve të këshillit në këtë bërberje.

Flamur Bytyçi - nuk e kam të qartë sqarimin se si përfaqësohen shqipëtarët. Si ka mundësi me u shpall thirrje publike me u përfaqësu shqipëtarët? Edhe te pjesa e mediave dhe OJQ-së. A e kanë dërgu mediat lokale të Suharekës një letër (procesverbal) se kush i përfaqëson? edhe te OJQ-të. A mundet dikush me marrë përsipër, me thanë po, është mbajtur një takim dhe na e kemi një procesverbal të mbledhjes që është mbajtur për këtë çështje. Kjo procedurë nuk më duket në rregull.

Avni Bytyçi - ky vendim është në harmoni dhe përpunueshmëri edhe me ligjin për policinë e Kosovës dhe me udhëzimet administrative. Kryetari i Komunës i ka ndjek të gjitha procedurat. Udhëzimi thotë: nga një përfaqësues të secilit komunitet etnik të komunës. Komunitetet etnike të komunës janë komunitete shqipëtare dhe komunitete tjera pakicë. Të gjitha komunitetet janë të përfshira në kuadër të këtij këshilli dhe propozimet kanë ardhë nga përfaqësuesit dhe nga OJQ-të ka ardhë nga Hendikosi Luljeta Tafolli e cila do ti përfaqësojë përfaqësuesit e komuniteteve me nevoja të veçanta.

Flamur Bytyçi - kërkoj një raport nga Kryetari për mbledhjen e OJQ-së, mediave dhe të shqipëtarëve për formën e përzgjedhjes.

Dardan Berisha - realisht ne nuk e kemi pa thirrjen publike. Ne kemi pas shqetësime të jashtëzakonshme sa herë që janë mbajtur komisionet e KKSB-së dhe kemi pas dhe reagimet tona kur kanë ardhë raportet e këtij komisioni. Kërkoj një interpretim ligjor nga zyrtari ligjor se a kemi të drejtë ne sot me pas propozime prej legjislativit, prej të gjitha partive politike që jemi këtu në kuvend me pas një përfaqësues në këtë komision që të ngrihet zëri i gjithë neve.

Ani Bytyçi - edhe mandatin e kaluar është kërkuar një propozim i tillë mirëpo udhëzimi administrativ takstativ i potencon se cilat pozita duhet të jenë në kuadër të këshillit dhe ne iu kemi përmbajtur atij udhëzimi administrativ. Nuk lejohet të jetë nga legjislativi asnjë anëtar në KKSB.

Dardan Berisha - nuk kam unë asgjë kundër emrave që janë këtu. Ka anëtar të tjerë që janë të komuniteteve që janë këtu, p.sh edhe në komisionin për komunitet dhe janë pjesë e këtij këshilli. Pse nuk bën ne me pas përfaqësues duke pas parasysh që edhe ekzekutivi ka disa anëtar që kanë qenë në të kaluarën por dhe tash janë pjesë e këtij këshilli. Mendoj që ne si legjislativ duhet me pas një përfaqësues i cili ka me ngrit zanin në takimet që do të mbahen duke pas parasysh rregulloren dhe pikat e rendit të ditës që i përcakton ky kuvend.

Avni Bytyçi - udhëzimi e thotë që kryesuesi i Komitetit për Komunitete shkon me automatizëm në këshill ndërsa përfaqësuesit tjerë të komuniteteve që janë të përfshirë në këshill, janë propozime që kanë ardhë nga komuniteti pakicë andaj i kemi fut në kuadër këshillit.

Antigona Zyba - sot po shqyrtojmë projekt-vendimin për themelimin e KKSB-së, një mekanizëm shumë i rëndësishëm për rritjen e sigurisë dhe problemeve dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe qytetarëve. Si pike kyçe isha ndal te siguria në shkollë. A i kemi të gjitha shkollat e paisura me kamera? Nëse po, a janë të monitoruara dhe nga kush monitorohen? Kamerat duhet të kapin çdo kënd të vdekun në oborret e shkollave sepse aty po fillon gjithëçka dhe po vjen deri te më e keqja. Plan tjetër do të ishte bashkëpunimi më i ngushtë me policinë, në patrullimet më të shpeshta nëpër shkollë. Shqetësim tjetër janë edhe qentë endacak nëpër lagje e nëpër qytete e nëpër fshatra të ndryshme, pastaj edhe mungesa e ndriçimit që në shumë vende është por nuk është në funksion. Kisha propozu që KKSB-ja të na raportojë më shpesh në Asamble.

Kryesuesi - ne jemi duke e themeluar këshillin kurse planin e punës veq e ka dhe është obligim me raportu.

Urim Suka - ne e dime që është obligim i joni që duhet me formu këtë këshill në bazë të ligjit për policinë dhe dime që shumica e këtyre anëtarëve janë të paraparë me udhëzim administrativ por siq e shohim që edhe disa pozicione që nuk janë të paraparë me udhëzim administrativ. E kuptoj që askund

në ligj nuk shkruan që duhet me qenë një përfaqësues i legjislativit ose asamblesë por nuk do të thotë që me patjetër nuk duhet me qenë. Kur jemi te pozicioni që e ngritëm ne, te përfaqësimi i shqiptarëve, kush ma mirë mundet me i përfaqësu shqipëtarët se sa ne që jemi të votuar prej qytetarëve. A më mire i kish përfaqësu shqipëtarët dikush prej neve që jemi të votuar për këtë punë apo dikush me një thirrje publike që ju e keni bërë nëpër terr dhe se ka pa askush atë thirrje? Mendoj që duhet me pas mirëkuptim për atë që tha Dardani dhe Flamuri, që përfaqësimi i shqipëtarëve mund të bëhet edhe te një përfaqësues i legjislativit ose 3-4 për deri sa ju e keni rrit sepse ka qenë numri më i vogël më herët.

Kryesuesi - nëse e lidhim te puna e votuesve, ne e kemi Kryetarin e komunës që është i votuar prej qytetarëve dhe është kryesues i komisionit. E hedh në votim pikën 3.

19 për, 8 apstenime, Miratohet pika 3

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit të komisionit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Qëndrim Elshani - MAPL ka konstatu se vendimi i asamblesë nuk është në pajtim me legjislacionin dhe ka kërku harmonizimin e tij brenda afatit ligjor prej 30 ditëve. Vendimi i miratuar me 30.05.2025 nuk ka specifikuar qartë përfitimin financiar të komunës nga dhënia në shfrytëzim e parcellës në fjalë dhe përcaktimi i thjeshtë i përqindjes së ndërtimit nuk përbën kriter të plotë ligjor pa u shoqëru me një vlerësim konkret. Ligji për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës si dhe rregullorja kërkojnë që vendimi të përmbajë: vlerën e investimit të propozuar, numrin e të punësuarve që do të krijohen nga projekti, llojin e investimit dhe intetresin publik për komunën dhe përfitimin financiar dhe ekonomik të komunës. Vendimi aktual nuk i përmban këto elemente duke e bërë aktin e papajtueshëm me legjislacionin në fuqi. Këto kriteret nuk janë marrë parasysh nga komisioni vlerësues andaj MAPL e ka kthyer në rishqyrtim vendimin. Komisioni ka rekomanduar fituesin dhe ka përcaktuar kushtet por vendimi i asamblesë nuk ka respektuar plotësisht kërkesat e MAPL-së dhe ka miratuar një akt të mangët. Komisioni nuk ka marrë për bazë asnjë kontratë valide të cilën kompania e ka bërë me persona privat në hapësirë dhe kjo na bën të dyshojmë se prona publike po ipet në përqindje më të vogël me ato private edhe pse rregullorja e thotë që nuk mund të ipen nën 20%. Po ta marrim për bazë pronën e fundit që e ka dhënë kuvendi komunal është 27% dhe i bie që kjo prone për 6% më pak po ipet. Ne nuk e përkrahim këtë vendim pa u marrë parasysh këto kërkesa nga asambleja komunale: Të rishqyrtojmë vendimin 01-Nr-016-31320 dhe ta harmonizojmë me legjislacionin në fuqi; Të përfshijë në vendim vlerën e investimit të propozuar nga kompania, përfitimin financiar konkret për komunën, interesin publik të projektit; Të kërkojmë nga kompania dokumentacion shtesë për të plotësuar kriteret ligjore dhe të mos procedojë vendimin përfundimtar pa korrigjuar mangësitë e konstatuara nga MAPL-jatë;

Armend Krasniqi - komisioni ka përgaditur një raport me të gjitha specifikacionet të cilat i ka parapa ligji në fuqi, e ka dorëzuar raportin, e ka miratuar në asamble atë raport ku kanë qenë të përfshirë të gjithë asambleistat në votim. Asambleja e ka dërguar në ministrinë përkatëse dhe ministria përkatëse gjëja se ka gjetur një parregullsi të vogël. Mirëpo ajo parregullsi sipas mendimit tim nuk ekziston.

Nexhat Ramadani - edhe kolegu prej VV-së dha disa vërejtje për të cilat unë pajtohem por dua ta di nga Kryetari ose zyrtari ligjor, a ekziston një rregullore apo në çfarë forme përcaktohet interesi ekonomik i komunës në rastin e dhënies në shfrytëzim të një prone? Në çfarë baze përcaktohet, në rastin konkret që ka qenë 20%?

Armend Krasniqi - komisioni ka kompetencë të vendos përqindjet apo vlera të ndryshme të cilat ka të bëjë ai komision dhe në bazë të përcaktimeve të komisionit ne kemi arritur të shkojmë më tutje ndërsa rregulloret specifike se me sa përqind duhet me shku, nuk ka asnjë rregullore sa kam lexuar unë.

Nexhat Ramadani - ti po thua kompetenca mirëpo kompetenca ipet me një ligj ose me një rregullore. **Avni Bytyqi** - si zyrtar ligjor jep sqarime dhe thotë: si shoqëri, në aspektin e përgjithshëm kemi obligim me mbrojtë interesin e përgjithshëm të komunës dhe qytetarëve ndërsa ju si zyrtarë të lartë dhe zyrtarë tjerë kanë obligim ta mbrojnë interesin e përgjithshëm të kësaj shoqërie, kanë interes dhe obligim ligjor dhe moral ta mbrojnë interesin e përgjithshëm të komunës. Ky kuvend e ka dhënë vendimin paraprak për me i fillu procedurat e dhënies në shfrytëzim të kësaj prone. Ky kuvend e ka themeluar komisionin për të udhëhequr procedurat dhe i ka përcaktuar detyrat e atij komisioni dhe pikërisht ky kuvend ka për obligim të shqyrtojë. Konkretisht neni 22 i rregullores për procedurat e dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme e thotë që pas raportit të komisionit, kompetentë për ta shqyrtuar raportin dhe vlerësuar rekomandimin është obligim i kuvendit dhe kuvendi ka për obligim ta miratojë ose jo. Është kompetencë e kuvendit dhënia në shfrytëzim afatgjatë e pronës. Te shprehja e interes

decidivisht thotë:kriterët tjerë për dhënie në shfrytëzim të pronës përcaktohen në thirrjen publike.Në thirrjen publike i kanë përcaktuar komisioni dhe pavarësisht çka ka rekomanduar komisioni është e juaja të vendosni lidhur me këtë çështje.Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

Nexhat Ramadani - të gjitha këto procedura unë i di por unë bëra një pyetje konkrete.Ky komision a është në kuadër të detyrave të tij të përcaktoj këtë interes sepse aty duhet ekspertizë.Kush thotë 20 % ndërkohë që me çmimin e tregut ipen 27%-30% ndërsa komuna jep me 20%.Respekt për komisionin,përgjegjësia është e Kryetarit i cili ka për detyrë me mbrojtë interesin e komunës.Duhet me marrë një vlerësim ose ekspert,ose kompani e cila në një formë vlerëson këtë punë.Nuk dua ta nënçmoj komisionin por unë nuk besoj që janë ekspertë të kësaj lëmie.Nëse këta kanë bërë një procedurë ku kanë mbledh të dhëna ose kanë angazhu një ekspert ose një kompani e cila ju thotë që tregu është ky dhe ju nën këto nuk është mire me dhënë pronën e komunës,është në rregull.Ne kemi për interes pikërisht me mbrojtë interesin e qytetarëve dhe ne jemi dëshmitar që tregu e ka rrit çmimin dhe ne e japim me 20%.A jemi duke e marrë një vendim që është në interes të qytetarëve?Cila është vlera e asaj prone dhe për sa duhet me dhënë?

Armend Krasniqi - në komisionin të cilin e ka formuar Asambleja kanë marrë pjesë asambleistat të PDK-së,LDK-së,AAK-së dhe shoqërisë civile.Tokat të cilat janë dhënë përpara kanë pas çmim 20% dhe në bazë të asaj vlere,mirëpo këtu fatkeqësisht kemi pas vetëm një operator ekonomik që ka aplikuar me 21% dhe ka fituar ai.Përkundër që e kemi vendosur ne që ka fituar 21%,e kemi sjell në asamble dhe të gjithë asambleistat e kanë votuar.

Nexhat Ramadani - interesi mbrohet kur vendoset një kufi i arsyeshëm në bazë të tregut.Sa po e mbronin ju interesin si qeveri?

Kryesuesi - ai komision u formuar nga ky kuvend dhe ne po e miratojmë një rekomandim të komisionit.

Nexhat Ramadani - nuk ka një rregullore të qartë si përcaktohet por po e përcakton një komision i cili mundet mos me qenë ekspertë për këtë punë.Qysh mbledhjen e dytë që dy here po ballafaqohemi me vendimet që i kthen ministria.

Kryesuesi - këtu nuk po e shfuqizojmë vendimin por po e miratojmë.

Nexhat Ramadani - kur e ke sjell këtu është dashtë të futet edhe interesi ekonomik.Ne do ta votojmë kundër pikërisht për këtë se toka e komunës shkojë duke u dhënë me çmim të lirë i cili nuk është i arsyeshëm dhe nuk është konform tregut.

Liridon Fandaj - herën e kaluar kur ka ardhë ky vendim,unë të kam pyet se ku je bazu dhe atëherë ke thënë se rregullorja e përcakton pragun prej 20% e përpjet.Tash po thua që s'ka rregullore.A ka rregullore apo nuk ka? Nëse e bën një vlerësim si komision duhet me marrë një vlerësues dhe me pa sa është dhënë prona komunale ose private dhe në atë vend mirret për bazë kontrata e fundit dhe bëhet vlerësimi.Ju leje që nuk e keni marrë atë private por ka dy muaj përpara që e kemi dhënë një prone komunale me 27% dhe nuk e ke marrë për bazë.Sa i përket vendimit që ta ka kthyer ministria,a thotë që ti e ke shkel ligjin sepse në bazë të ligjit duhet me caktuar vlerën financiare sa përfiton komuna.Ju prap një vendim të tillë nuk e keni korrigjuar dhe prap e sillni me 21%.A jeni kundër atij që doni me ia dhënë apo veq po doni me bo lojta,me sjell në asamble e me kthyer ministria të njejtin vendim.

Armend Krasniqi - është e vërtetë që ministria e ka kthyer por përveq këtij vendimi,ne i kemi dërguar mbi 10 vendime në të njejtën formë ku nuk ka ndodhur me kthyer asnjë vendim tjetër të cilin e kemi dërguar në ministri.

Liridon Fandaj - nëse nuk ka kaluar me 21 %,ti nuk bën me që prap një vendim me 21%.Duhet me caktuar vlerën financiare prap.

Armend Krasniqi - Liridoni po thotë nëse e kërkon vlerën totale që e ka paraqitur të investimit dhe nuk e ka specifikuar zyrtari ligjor kur e ka dërguar në MAPL,ne mundemi me bashkangjitur vlerën e investimit të cilën e ka aplikuar operatori ekonomikë.

Liridon Fandaj - nëse nuk ceket vlera financiare është më mire me rregulluar vendimin me 21%,me kthyer në vlerë financiare dhe atë vërejtje që e ka dhënë ministria,me kaluar ky vendim por jo me shkuar në ministri prap e m'u kthyer vendimi.

Kryetari - kjo prone që është dhënë,ku ka shkuar dokumenti në MAPL nuk është vendosur në përqindje,mirëpo në fund formohet një komision tjetër kur të njoftohet objekti dhe përcaktohet interesi i komunës me 21% të pronës së vet që e ka.Këso raste kemi me pas të rruga "Skënderbeu" dhe të rruga kryesore që shkon për Shtimje.Shumë mire është me shfrytëzuar komuna 2 banesa apo 3 banesa se sa me mbet vjerrina.Ju them që çdo kush që ka me lyp pronën,veq një ka me konkurr sepse nuk ka mundësi me konkurr me 3 ari sepse ju e dini që leje nuk lëshohet në Suharekë më pak se 14 ari.

Liridon Fandaj - ne nuk jemi këtu për mos me mbrojtë interesin komunal por për me mbrojtë interesin komunal dhe nëse ti thua që ne duhet me bo një vlerësim financiar,ligji nuk e thotë.Realisht me këtë që e ka kthyer ministria,realisht komisioni nuk e ka caktuar dhe nuk e ka zbatuar ligjin për dhënie në shfrytëzim

të pronës. Ju po e sillni prap me 21% dhe nuk po e caktoni vlerën financiare dhe kjo kthehet. Më mire është me caktu vlerën financiare dhe me kalu kjo se sa ne mu marrë prap me të njëjtin vendim. Duhet edhe komuna me pas një vlerësues dhe me shku me vlerësu.

Kryetari - plotësisht pajtohem, por ne së pari duhet ta dimë sa kat shkon ai objekt sepse lejen nuk e di që e ka marrë.

Liridon Fandaj - ai e ka lejen dhe e ka projektin.

Kryetari - unë flas për pjesën e komunës. Kur të përfundon formohet një komision nga asambleja komunale, sa metra katror i kemi dhënë e sa na takon përqindja. Vendos një komision e ato pastaj mbështet pjesën të komunës. Kur ka shku në MAPL, nuk ka shku 21%-shi nëse nuk gaboj.

Kryesuesi - kanë kërku me inkorporu atë 21 %-shin në vendim.

Nexhat Ramadani - meqenëse Kryetari e dha një sqarim më adekuat për shkak se atje shkruan interesi ekonomikë - vlera financiare. Për shkak se neni 2 ka mungu në vendimin e kaluar dhe tash është vendos dhe besoj tash është më në rregull. Edhe ne jemi të interesuar pronat e komunës mos me nejt pa u shfrytëzu por Kryetar ki përgjegjësinë që ato prona me i dhënë konform vlerës që kanë dhe tregut që ekziston.

Kryetari - nuk cakton Kryetari i komunës çmim. Është ankandi publik dhe ankandi publik mundet me shku edhe me 15% nëse nuk gaboj. Asnjëri prej juve në rrugën e Reshtanit ku janë 2-3 ari edhe me 2% me iu dhënë s'keni me hy sepse ski interes.

Kryesuesi - MAPL konstaton se vendimi 01-Nr-016-31320 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës që ka nxjerr kuvendi i komunës së Suharekës, nuk ka përcaktu përfitimin ekonomikë në vendim. Tash po e vendosim dhe përfitimi ekonomikë është 21%.

Urim Suka - ne u morëm me çështjet teknike e në fakt vendimi për të cilin ne si grup i asambleistëve jemi kundër, nuk ka të bëjë fare me këto çështjet teknike por ka me përmbajtjen. Komuna të gjitha parcelat që i ka ku parashihen me HZK mu bë ndërtim dhe ku janë vjerrina, edhe ne jemi me i kthi në zhvillim e ndërtim. Nëse ajo tokë, ajo 3 ari kish qenë e imja dhe shkon në treg me 30%, unë kurrë nuk e kisha dhënë me 21%. Ka ardhë deri këtu dhe vendimin po thoni e merrni ju. Këtë 21% nëse ne e votojmë, ne e kemi përgjegjësi dhe nuk e kanë përgjegjësinë më këta sepse këta e kanë sjell te na. Ky 21% nuk e mbron intersin qytetar se me 31 % po shkon atje. Ne e votojmë kundër.

Kuvendi i komunës le ta mer një vendim të ri pas vlerësimit real mbi vlerën e pronës, ne e votojmë vendimin.

Armend Krasniqi - vendimi për formimin e komisionit kur ka ardhë në Asamble, ka propozu AAK-ja një anëtar, propozon PDK, nuk ka pas anëtar, propozon LDK-ja një anëtar që për mendimin tim është shumë i arsyeshëm dhe ekspert i mirë. Bashkarisht me ekspertin e LDK që e ka dërgu LDK-ja e PDK e AAK, drejtorat, shoqëria civile kanë vendos 21 % që ti i ke thënë atij sepse në rregull është. Ka ardhë në Asamble dhe Asambleja e ka kalu dhe për gabim teknik e ka kthi ministria.

Kryesuesi - nuk ka qenë gabim teknik. Në të kaluarën gjithmonë është dërgu vendimi në atë formë. Po e kërkon tash me e fut në vendim dhe në rregull është.

Urim Suka - Krejt bashkë, edhe a i LDK-së nëse ka qenë, edhe unë nëse kam qenë në atë komision, kush do që e ka sjell këtë rekomandim për me votu na dhe për me na lanë fajin neve, krejt bashk ne jemi për me hudhë posht sepse ka bo gabim. N'koft i joni, edhe i joni ka bë gabim.

Flamur Bytyçi - kjo që përmendi Kryetari paraprakisht, që nuk kemi mujt me ditë sa kat është për me nda përqindjen, Drejtoria e Urbanizmit kanë mujt me ditë saktë me Hartë Zonale dhe me i lëshu parakushte komisionit që me i shërby këtyre që me rrit përqindjen.

Kryetari - nuk mundet me marrë leje pa pas marrëveshje ose kushtet. Pa e marrë këtë pronë nuk mundet me iu bashkangjit pronës për interes privat dikuj. Kryetari tutje jep sqarime.

Visar Kuçi - sa e di unë kjo është prona e katërt në komunën e Suharekës për ndërtim. Komisioni në këtë rast e ka caktu një prag 20%. Unë para kësaj procedure kam marrë pjesë në një komision për dhënie. Edhe ne atëherë e kemi vendos pragu 20% sepse jemi bazu te procedurat e fundit ku e kemi pas me 17% në "Brigada 123" dhe dikund mbi komunë ka qenë me 20% e fundit. Investitori i parafundit ka thënë që e ka dhënë 27% sepse ashtu e ka marrë nga privati. Ndoshtado të ishte më mire që në të ardhmen komisioni për dhënie në shfrytëzim me pas një pikë ku baza e dhënies mu marrë ashtu si janë bë kontratat te noteri në zonën më të afërt përrreth dhe vendos pragu. Unë propozoj që të kaloj edhe kjo pronë. Komuna ka me përfitu më mire 21% sepse ka shumë vite, 25 apo 30 vite që është shfrytëzu kjo pronë dhe kurrë s'ju ka pagu komunës. Ndoshta procedura po i ndëshkon investitorët sepse investitori ka apliku te ne për kushte ndërtimore qysh para 2 viteve apo 3 por me aprovimin e planeve hapësinore ne tash po ia kushtëzojmë investitorit, i themi që në bllokun ku ti ke apliku për kushte ndërtimore është edhe një parcellë, si në këtë rast me 348m² që ti je i obliguar me fut në bllokun tonë të ndërtimit por nëse është privat, del me privatit merret vesh. Drejtori tutje jep sqarime.

Nexhat Ramadani - drejtori tha që ka qenë në komision edhe një anëtar i LDK-së. Unë kam bisedu me të paraprakisht dhe ashtu si tha Liridoni, ai tha që ne në komision i kemi bërë pyetje zyrtarit ligjor apo kujt ka qenë prezent aty se a ka një rregullore dhe kanë thënë që ka një rregullore. Ndërsa tash po shihet që s'ka rregullore. A është me ligj te komisioni kjo kompetencë për me vlerësu? Te pjesa e votimit jemi të qartë se si votojmë por shqetësimi ishte sa po e mbron interesin e komunës Kryetari.

Laureta Tafaj - sa i përket kësaj teme, kritikën dhe kundërshtimet i kam dhënë në KPF. Nuk kam me askënd personale por ajo që më vrau në vesh është fjala e Avniut dhe e drejtorit kur tha: ky kuvend e ka votu këtë projekt-vendim dhe ky kuvend e ka votu edhe komisionin. Kjo po tregon që ky kuvend, që jo të gjithë ne por po na përfshin përsëri të gjithë duke i pas numrat për me i votu të gjitha projektet, po shkel të drejtën e qytetarëve. Nuk po i mbrojmë të drejtat e qytetarëve, nuk po e mbrojmë pronën publike për të cilën mendoj që ndjekemi ligjërisht nëse nuk e mbrojmë pronën publike. Andaj ju bëj thirrje kolegëve që të vendosni me zemër dhe me mendje të pastër për të drejtat e qytetarëve.

Avi Bytyqi - zyrtari ligjor edhe një here jep sqarime sa i përket të gjitha procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

Laureta Tafaj - mire e the dhe nuk ka të bëj me atë profesionale që the.

Labinot Halitjaha - dua të kapem te fjala përfundimtare e drejtorit ku drejtori tha se është fajala për 21% të pjesës neto. Nëse është pjesa neto 21%, çfarë koeficienti është pjesa neto me pjesën bruto?

Visar Kuçi - kjo parcellë që është e komunës dhe ai bllok ndërtimi që janë edhe parcella private, koeficientin maksimal e ka 3. 21% neto, është vetëm sipërfaqja që ka me marrë komuna, 21 bruto hyn edhe hapësirat e përbashkëta ku hyn koridori, lifti, shkallët etj. Drejtori tutje jep sqarime.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4.

14 për, 12 kundër, Miratohet pika 4

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - elaboron pikën dhe thotë që komisioni do të ketë 2 anëtarë nga kuvendi, 2 nga ekzekutivi dhe 1 nga shoqëria civile. Kërkoj propozimet.

Flamur Bytyçi - në emër të grupit të LDK-së propozoj Doruntina Zenelaj.

Aziz Bytyqi - në emër të grupit të AAK-së propozoj Albulena Kokollarin.

Dardan Berisha - në emër të grupit të PDK-së propozojmë Labinot Halitjaha.

Laureta Tafaj - dua ta cek që nga praktikat e mëparshme opozita pothuaj asnjëherë nuk është përfshi nëpër komisione të cilat janë tejet të rëndësishme, andaj kësaj here dhe herëvë të tjera kur pozita dhe partia në koalicion me të kanë propozime, ne nuk do të kemi propozime. E lus drejtorin që pa e pyet diçka të mos përgjigjet.

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin e LDK-së për Doruntina Zenelaj.

7 për, 11 kundër, 5 apstenime

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin e AAK-së për Albulena Kokollarin.

14 për, 7 kundër, 4 apstenime.

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin e PDK-së për Labinot Halitjaha.

12 për, 7 kundër, 5 apstenime

Kryesuesi konstaton që sipas votave shkon Albulena Kokollari dhe Labinot Halitjaha.

Kërkon propozimet nga Kryetari.

Kryetari - Armend Krasniqi, Mensur Selimaj dhe nga shoqëria civile Suzana Gashi.

Urim Suka - mora shkas nga ideja e Kryetarit për propozim nga asambleja. Në njërin anë e ka përgadit pjesën e vet për me i zgjedh kandidatët veç të koalicionit qeverisës, në anën tjetër atë që nuk lejon ligji, as nuk është konsultu me ligjin edhe po don m'u bë mirë dhe me propozu prej asamblesë. Tani ne i kemi edhe tri komisione tjera. Nëse ju po doni me u bë kaq gjeneroz, e aq më tepër ku kemi të bëjmë me komision të ankesave, ku kemi të bëjmë me komision të ndërmarrjeve publike, hajde merrne përgjegjësinë dhe jepne një anëtar nga opozita. Merre guximin Kryetar dhe vendos.

Kryesuesi - e hedh në votim komisionin me këtë përbërje: Albulena Kokollari, Labinot Halitjaha, Armend Krasniqi, Mensur Selimaj dhe Suzana Gashi.

14 për, 7 kundër, 4 apstenime, Miratohet pika 5

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave;

Kryesuesi - edhe ky komision përbëhet prej 5 anëtarëve, 2 nga legjislativi, 2 nga ekzekutivi dhe 1 nga shoqëria joqeveritare. Kërkoj propozimet.

Aziz Bytyqi - në emër të grupit të AAK-së propozojmë Mimoza Bajraktari.

Astrit Salihu - në emër të grupit të LDK-së propozojmë Vlora Kryeziu.

Dardan Berisha - grupi i PDK-së nuk ka propozim.

Laureta Tafaj - LVV nuk ka propozim.

Jehona Rrafshi Lumi - Nisma nuk ka propozim.

Kryetari - Shqipron Bytyqi, Emrush Bytyqi dhe nga shoqëria joqeveritare Refki Zogaj.

Kryesuesi - e hedh në votim komisionin me këtë përbërje: Mimoza Bjaraktari, Vlora Kryeziu, Shqipron Bytyqi, Emrush Bytyqi dhe Refki Zogaj.

21 për, 4 apstenime, Miratohet pika 6

Pika 7. Sqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale „Stacioni i Autobusave“ ;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe thotë që komisioni ka mandat po aq sa ka mandat kuvendi komunal. Komisioni do të ketë 3 anëtar ku 2 përcaktohen nga legjislativi dhe 1 është propozim i Kryetarit. Kërkon propozimet.

Aziz Bytyqi - në emër të grupit propozojmë Edon Sadikaj.

Dafina Kolgeci - nga LDK propozojmë Astrit Salihu.

Dardan Berisha - grupi i PDK-së propozon Afërdita Mamaj.

Laureta Tafaj - LVV nuk ka propozim.

Jehona Rrafshi Lumi - Nisma nuk ka propozim.

Dardan Berisha - stacioni i autobusave e ka bordin dhe brenda bordit mund të përcaktohet edhe shuma e pagesës dhe duke llogaritur që stacioni i autobusave ka kalu 100% nën kompetencën e komunës dhe te pagesa neni 3 thotë: për punën që do ta kryej komisioni, do të kompenzohen nga stacioni i autobusëve. Pra nuk do të dëmtohet buxheti i komunës. Unë propozoj që pagesa e këtij komisioni me qenë 200 € siq ka qenë në legjislaturat e kaluara. Unë kam pas takim me anëtarët e bordit dhe ata kanë konstatu që kanë buxhet për me i mbulu këto shpenzime.

Kryesuesi - realisht pagesën e cakton kuvendi për çdo komision dhe propozimi i PDK-së është që pagesa të jetë 200€.

Urim Suka - Ne formojmë komisione plot dhe nuk ka kuptim një komision me pas një meditje tjetër, një komision me pas meditje tjetër. Mendoj që duhet me shku njëtrajtshëm, barabart si çdo komision që formohet. Nuk e mbështesim një ide të tillë.

Laureta Tafaj - nuk e përkrahim propozimin për me shtu vlerën e komisionit.

Flamur Bytyçi - nuk pajtohem me atë që tha Dardani për faktin që nuk dëmtohet buxheti i komunës. Realisht dëmtohet buxheti i komunës për shkak që është aset i komunës. Duhet me u votu kundër kjo pjesë. Edhe komisionet tjera janë të rëndësishme, kanë angazhime dhe kanë me raportu.

Dardan Berisha - në parim nuk pres me u pajtu as Urimi e as askush me propozimin tim siq su pajtova unë me propozimin e Urimin në fillim të seancës. Unë e dhashë këtë propozim në kuadër të pasqyrës financiare të NLB Stacioni i autobusave dhe duke iu referu nenit 3. Çdo herë ka qenë e njejta pagesë dhe unë mendoj që ky propozim duhet me u hudh në votim.

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin e AAK-së për Edon Sadikaj.

15 për, 3 apstenime

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin e LDK-së për Astrit Salihun.

7 për, 13 kundër, 5 apstenime

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin e PDK-së.

13 për, 9 apstenime

Kryesuesi konstaton që sipas votave në këtë komision nga kuvendi shkon Edon Sadikaj dhe Afërdita Mamaj.

Kryetari - propozon Ilir Vocin.

Urim Suka - pak më herët zyrtari ligjor tha që shkojnë 2 prej legjislativit dhe nuk ka të drejtë tjetër, tash Kryetari po e propozon prej legjislativit. Kërkoj interpretim ligjor për këtë çështje.

Avni Bytyqi - ligji për ndërmarrjet publike neni 5 e thotë: çdo komunë që është aksionar i një ndërmarrje publike lokale, themelon komisionin komunal të aksionarëve. 2 shkojnë nga kuvendi dhe 1 e propozon Kryetari i komunës dhe kur t'vje propozimi nga Kryetari i komunës, nënkuptohet që e jep nga ekzekutivi

dhe ky komision vepron dhe punon në emër të kuvedit dhe në emër të komunës së Suharekës për çështjet e caktuara që kërkohet në çështjen e ndërmarrjeve publike lokale.

Urim Suka - nëse e kuptova,tha duhet me qenë nga ekzekutivi edhe pse pak si politike e kthej përgjigjen.

Avni Bytyqi - as ty dhe asnjë anëtar të asamblesë,as një gjysëm fjale nuk e jap politike,por atë që e di dhe e mendoj e jap profesionale.

Urim Suka - propozimi i Kryetarit nënkupton me qenë nga ekzekutivi dhe në rastin konkret nuk është nga ekzekutivi.

Kryesuesi - Kryetari po e emnon.

Urim Suka - je duke marrë një vendim që është në kundërshtim me ligjin mbi bazën e fjalëve që the më herët.E kemi pas situatën e njejtë edhe mandatin e kalaur.Ndërmarrjet publike nuk janë vetëm të kualicionit AAK-PDK,ndërmarrjet publike janë të krejt qytetarëve.Të paktën respektoni ligjin.

Kryesuesi - e hedh në votim komisionin me këtë përbërje:Edon Sadikaj,Afërdita Mamaj dhe Ilir Voci.

15 për,7 kundër,4 apstenime,Miratohet pika 7

Kryesuesi - faktikisht Dardani kërkoi një propozim.Dardan në seancën tjetër kërkoje si pikë shtesë.

Pika 8. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale „Eko Regjionin“ ;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe thotë që ky komision përbëhet prej 3 anëtarëve ku 2 do të jenë nga legjislativi dhe 1 propozohet nga Kryetari.Kërkoj propozimet.

Aziz Bytyqi - në emër të AAK-së propozojmë Syl Zenelaj.

Urim Suka - në emër të grupit të LDK-së propozojmë Nexhat Ramadani.

Dardan Berisha - PDK propozon Demokrat Vataj.

Antigona Zyba - LVV nuk ka propozim.

Jehona Rrafshi Lumi - vazhdoni me propozimet tjera.

Liridon Fandaj - edhe herën e kaluar është themelur një komision dhe asnjëherë nuk kemi marrë një raport nga ky komision se çka është duke ndodh me ndërmarrjen.As nuk e dimë ato 13.1% sa e kanë vlerën dhe sa janë investimet gjatë këtij mandati katër vjeçar në ndërmarrje.Mos ta themelojmë një komision sikurse mandatin e kaluar dhe mos ta kemi një raport.

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin e AAK-së për Syl Zenelaj.

14 për,5 apstenime

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin e LDK-së për Nexhat Ramadani.

8 për,10 Kundër,1 apstenim

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin e PDK-së për Demokrat Vataj.

14 për,5 apstenime

Kryesuesi konstaton që sipas voatve në këtë komision shkon Syl Zenelaj dhe Demokrat Vataj.

Kryetari - propozoj Jehona Rrafshi Lumi.

Kryesuesi - e hedh në votim komisionin me këtë përbërje: Syl Zenelaj,Demokrat Vataj dhe Jehona Rrafshi Lumi.

14 për,6 kundër,5 apstenime,Miratohet pika 8

Pika 9. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Liridon Fandaj - ky komision edhe pse është themelur me vonesë sepse dëmet kanë ndodh më herët dhe pas një muaji është formu komisioni,ky komision e ka sjell një raport.Bazuar në raportin e komisionit vlere totale e dëmit arrin 117,353.87, ekonomi familjare janë 47 kërkesa me vlerë 57,339.00, sektori i bujqësisë 31 kërkesa me vlerë 60,014.87.Në këtë raport janë 18 kërkesa të refuzuara pa u dhënë asnjë arsytim ligjor apo teknik për këto vendime që janë marrë,mos po bëhet shkelje ndaj atyre që janë dëmtu?Nuk mendoj që ndonjë qytetar bën kërkesë nëse nuk është prek prej vërshimeve.Duhet me dhënë një sqarim dhe me pas dokument dhe raport.Ne jemi për me i përkrah të gjithë ata që janë prekur por jo me i selektu.Si vendim është i mangët dhe do të duhej që të plotësohej dhe të ketë informata për 18 kërkesat e refuzuara.

Kryesuesi - ne në KPF e kemi diskutuar sepse ka qenë edhe kryesuesja e komisionit ku ajo dha sqarime sepse siç e dini edhe në nivel qeveritar është formuar një komision për vlerësimin e dëmeve në nivel të Republikës së Kosovës dhe pas miratimit nga Kuvendi të vlerësimit të dëmeve, ai komision përsëri ka me dalë në teren dhe me verifikuar dëmin.

Liridon Fandaj - nuk mundem me votuar një raport kur komisioni ka me dalë prap me verifikuar.

Kryetari - ne e kemi pasur një telefonatë prej kryeministrit, është krijuar një komision në nivel të Republikës së Kosovës. Ne kemi shkuar në shpallje duke i ditur dëmet kur i kemi paguar në 2019 nëse nuk gabojmë ku komisioni ka qenë i caktuar nga Asambleja komunale por kemi bërë gabim atëherë që nuk kemi shkuar me protokollet. Thirrja është bërë publike dhe të gjithë ata që kanë pasur dëme, kanë konkurruar dhe është numri i protokollit. Është e vërtetë që disa iu kanë refuzuar për arsye se në atë kërkesë ndoshta ka pasur edhe dëme që janë bërë para 7 vite ku i kanë gjetur përmes gjykoresh. E kemi vetëm një mospajtim me një qytetar të Suharekës ku bletët i ka pasur në komunën e Prizrenit dhe anëtarët e komisionit nuk kanë të drejtë prej Suharekës me shkuar dhe me vlerësuar dëmin në një komunë tjetër. Dy komisionet janë duke bërë një marrëveshje me rregull atë punë. Është publike por dosja është shumë e madhe dhe nuk ka mundur të vijë këtu. Janë me emra dhe mbiemra por sipas ligjit në fuqi emri, mbiemri, nr. personal duhet të hiqen. Duhet me kaluar përmes asamblesë por komisioni nga qeveria do ta mbikqyr edhe një herë.

Liridon Fandaj - Kryetar ne nuk kemi nevojë me miratuar nëse ka me pasur rivlerësime dhe ndryshime. Pjesa e bletëve që theksohet, ata i kanë të regjistruara koshet edhe në Ministri të Byqësisë që subvencionohet për ato dhe ju lejohet mi bartë ato me ligj. Pajtohem me Kryetarin që ndoshta dikush ka desht me përfituar por edhe vlerësimi u bërë i vonshëm. Sqarimet për këto 18 kërkesa të refuzuara është dasht të jenë në raport që ky raport me kaluar edhe pse ju po thonë që prap ka me pasur rivlerësim dhe nuk mendoj që ky raport duhet me kaluar në asamble.

Kryetari - çmimet i ka përcaktuar komisioni në bazë të katalogut.

Urim Suka - ne në mbledhjen e parë këtë mandat patëm kërkuar që secili propozues i pikës së vet me dalë dhe me elaboruar. Merrne si vërejtje serioze për me kthyer këtë kuvend edhe pak më përgjegjshëm. Unë shpreh një keqardhje për gjithë ata qytetarë që janë prekur nga këto vërshime dhe urojmë që vlerësimi të jetë bërë sa më mirë nga komisioni dhe dëmi që iu ka shkakton të dëmshpërblehet. Raportin që e përgadit një komision është obligim ligjor me ardhë në kuvend dhe me u miratuar në kuvend dhe ky raport pastaj i drejtohet komisionit që është qeveritar nga zyra e kryeministrit dhe ai komision qeveritar mandej e bën vlerësimin e vet dhe mendoj që mund të funksionoj edhe ajo. Ajo që na shqetëson tash është se ne duhet me marrë vendimin dhe për deri sa ne duhet me marrë vendimin duam që të kemi informata më shumë, sepse ne jemi duke dasht me votuar. Andaj transparenca është dasht të jetë më e madhe. Anëtarët tanë në KPF kanë kërkuar specifikisht që me u ditur me emra dhe mbiemra se kush janë ata që kanë aplikuar. Ne nuk po themi ti publikojmë por ne që kemi me marrë këtë vendim mund të kontaktojmë se a ka shkuar gjithëçka në rregull dhe e dimë se si me marrë vendimin. Edhe ato që tha Liridoni që janë refuzuar, pse janë refuzuar që ta dimë ne a me votuar. Ne jemi të gatshëm me votuar duke e marrë për bazë që spo dojmë me i vonuar qytetarët.

Amir Hoxha - e dini që jam bërë drejtor pas formimit të këtij komisioni mirëpo të gjeturat dhe informatat që i kam është që këto kanë shkuar mbas thirrjes së Kryetarit kur është formuar komisioni. Ankesat kanë ardhur sipas protokollit dhe komisioni i ka trajtuar ato ankesa. I ka ka bërë kofident numrat personal siq i keni kërkuar në KPF dhe e ka sjellë këtë raport. Për çështjen e ankesave, di të them që ende sot vijnë me bërë ankesa njerëzit. I bëjnë ankesat të pa baza, kryesisht në sektorin e bujqësisë. Komisioni i ka trajtuar të gjitha ato por përfundimin e ka bërë bashkë me komisionin qeveritar dhe i kanë trajtuar secilën lëndë veq e veq dhe me sugjerimin e tyre e kanë përmbyllur.

Urim Suka - unë e vlerësoj punën e komisionit por unë kërkoja informata më shumë sepse do ta kishim më të lehtë me marrë vendimin. Ne do ta mbështesim për shkak që të mos vonohet.

Liridon Fandaj - a është ky raport përfundimtar për këto vërshime dhe a ka me u shqyrtuar edhe ndonjë kërkesë tjetër? Nëse është përfundimtar atëherë e dimë që nuk ka me u shqyrtuar. Nëse Kryetari thotë ka me analizuar edhe një kërkesë që është refuzuar, atëherë ky nuk është përfundimtar.

Kryesuesi - është përfundimtar.

Amir Hoxha - çmimi ka me u vendosur përfundimisht prej zyrës të komisionit qeveritar.

Liridon Fandaj - në KPF nuk keni thënë që është përfundimtar.

Amir Hoxha - për deri sa komisioni e ka përfunduar punën e vet, si mos me qenë përfundimtar!

Liridon Fandaj - Kryetari tha që ka me u analizuar ai i bletëve.

Kryetari - për neve është përfundimtar.

Dardan Berisha - në mungesë të komisionit por përmes drejtorave dhe Kryetarit po mundohemi me marrë një përgjigje të saktë. Unë në KPF nuk kam qenë i pajtimit me një raport shumë të shkurt kur tregon vetëm vlerën prej 117.000€ që janë nda për këto dëme. Në mungesë të komisionit specifikisht

dashta me ngrit çështjen e një bletari. Në materialin shtesë që e keni sjell, ato janë vetëm me kode sepse unë e kam marrë një mesazh që ato janë kofidenciale dhe nuk po dua të lakoj emra. Është një bletar i cili ka 58 bletë, është i qytetit të Suharekës por ne e dimë që bleta është insekt që lëviz dhe për shkak të kullosave, ai ka qenë në Prizren por konkretisht emri i tij nuk figuron si i dëmtuar.

Flamur Bytyçi - në KPF kam kërku që raporti me qenë pak më i detajuar, këtu u diskutu që me qenë kofidencial. Dua ta di kush e ka cilësuar dokumentin si kofidencial, ku janë bazu? Për deri ligji për financa publike e thotë qartë që çdo shpenzim që bëhet, ti ke drejtë. Ne kur kemi nda mjete nëse iu ka kall dikuj shtalla, ne e kemi bo me emra. Do të thotë ne që 4 vite e paskemi shkel kofidencialitetin.

Me i vendos emrat këtu është shumë më mirë për shkak që secili prej nesh mundet me shku me një lokalitet dhe me kontakti që është bërë vlerësimi si duhet a jo.

Jehona Rrafshi Lumi - ka qenë e domosdoshme sot gjithëqysh me qenë dikush prej anëtarëve të komisionit ose kryesuesi i komisionit. Ju i keni diskutu në KPF ndërsa unë nuk kam qenë pjesë e KPF-së. Mendoj që herave të tjera çdo raport që bëhet, me qenë dikush prej komisionit me dhënë llogari pak më shumë. Ky raport nuk specifikon në bazë të cilës rregullore apo bazë ligjore janë përcaktuar dëmet dhe kjo e bën këtë raport jo transparent. Dua të di se a kanë marrë palët ndonjë vendim se pse u është refuzuar kërkesa, gjithëashtu edhe atyre që u është miratuar kërkesa. Ky raport që vulos këtë çështje është që kemi një vulë të protokollit ndërsa nuk kemi vulë përfundimtare në fund dhe mendoj që nuk është e plotëfuqishme. Unë do ta votoj këtë raport për arsye se janë dëmet të qytetarëve ndërsa përgjegjësitë ligjore do ti jep komisioni.

Armend Krasniqi - është shqetësuese dhe problematikë e madhe lidhur me çështjen e fermerit të cilit iu kanë dëmtuar 58 bletë. Duhet ta trajtojmë pasi qenka raport përfundimtar dhe duhet ta fusim edhe këtë fermer në listën e fermerëve tjerë të cilët kanë përfitu. Një fermeri iu kanë dëmtu bletët dhe kur ka ardhë me apliku në Suharekë për vlerësimin e dëmit, komisioni ka marrë vendim që nuk kanë të drejtë me e vlerësu një dëm i cili ka ndodh në një qytet tjetër. Ky e ka tërhequr kërkesën e vet dhe e ka dërgu në Prizren mirëpo Prizreni i ka thënë që numri identifikues i fermës ekziston në Suharekë dhe Suhareka duhet me qenë përgjegjës për fermerët e vet. Prizreni ka bërë një procesverbal të dëmtimit të bletëve ku i ka bashkangjitur edhe fotot dhe dje i kam marrë në Prizren. Komisioni prej 3 anëtarëve ka nënshkru që problemi ekziston ku 58 bletë janë të dëmtuara mirëpo Prizreni nuk ka kompetencë me dërgu në asamble një fermer të Suharekës dhe me e dëmshpërbly për dëmin që i ka ndodh. Andaj ne pasi që është raporti përfundimtar duhet ta marrim këtë vlerësim, ta vlerësojmë dhe ta fusim në raport.

Liridon Fandaj - Kryesues, a është përfundimtar apo nuk është?

Flamur Bytyçi - a është kofidenciale apo nuk është?

Kryesues - unë nuk kam qenë pjesë e komisionit. Në KPF është diskutu dhe keni kërku një raport më të përgjithshëm dhe këta kanë shkuar në lokacione por emra nuk kanë vendos. Flamur mund ta bësh një kërkesë te komisioni dhe kërko sqarim pse.

Avni Bytyqi - zyrtari ligjor jep sqarime dhe thotë që ligji për mbrojtjen e të dhënave personale e obligon çdo institucion publik, në këtë rast Kryetarin e Komunës që ta caktojë një person përgjegjës që ti shqyrtoj të gjitha dokumentacionet të cilat kanë përbërje të kofidencialitetit. Komisioni e ka shqyrtu këtë kërkesë dhe besoj që është konsultu, edhe nëse nuk është konsultu, është dasht të konsultohet me personin përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale që është caktuar nga komuna dhe merret vendimi se a është kofidenciale apo nuk është por megjithatë komisioni ka vlerësuar që vendosja e emrave është kofidenciale për arsye se kemi pas praktika të tilla kur nga agjensioni për informacione na është tërhequr vërejtja dhe ka X raste që janë denu me shuma marramendëse pse i kanë bërë publike emrat e personave. Çështja e këtij raporti në procedurë administrative është përfundimtare. Kërkohej miratimi i kuvendit dhe komplet raportin Kryetari e ka për obligim me dorëzuar në agjencionin për menaxhimin e emergjencave në Prishtinë dhe një kopje do ta dorëzon në komisionin qëndror qeveritar. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

Nexhat Ramadani - besoj që këto sqarime Avniu i tha më herët por ne ende kemi paqartësi a është përfundimtare. Është mirë me thënë që e kemi bërë këtë gabim, a bën me e fut edhe këtë sepse ne jemi njerëz. Përfaqësuesi i grupit tonë parlamentar tha që ne kemi me e votu sepse nuk dojmë me i vonu ata njerëz por le ta dinë qytetarët që papërgjegjësia juaj i bën gjithë këto diskutime të kota.

Kryesuesi - e thamë që është përfundimtare.

Nexhat Ramadani - nuk është përfundimtare nëse ai i bletëve nuk është këtu sepse unë e kam pa këtë të bletëve.

Avni Bytyqi - dua ta sqaroj se pse komisioni nuk e ka bërë vlerësimin. Decidimisht në nenin 1 të vendimit që e ka themeluar Kryetari i Komunës thuhet që komisioni ka kompetencë dhe autoritet të bën vlerësimin e dëmit brenda territorit të komunës së Suharekës për arsye sepse edhe ligji për vetqeverisje dhe ligji për procedurën e përgjithshme administrative nuk e lejon me tejkalu territorin asnjë Kryetar të

komunës,përpos nëse dy komuna me marrëveshje e rregullojnë këtë çështje.Fakti ka ndodhur në territorin e komunës së Prizrenit dhe kompetencë për të vendos në territor është Prizreni. Nëse jo komisioni komunal,atëherë mund të vendos komisioni qeveritar për dëmet që iu kanë shkaktuar.

Kryetari - unë jam këshillu me komision qeveritar,vlerësimin nuk mundesh me bë në komunën e Prizrenit.Komisioni qeveritar është raport përfundimtar dhe këto dokumenta i ka punu gjithë ditën komisioni i komunës me komisionin qeveritar dhe ky është raport përfundimtar.Hajde merrni krejt letrat dhe shikoni një nga një me emra.

Armen Krasniqi - insisto me fut në mënyrë që ta ndihmojmë këtë fermer.

Nexhat Ramadani - para se të filloj debati për këtë pikë është dasht ta cekni këtë.Nuk është ideja me fajsu njeri tjetrin,duhet me pranue edhe kur të bëni gabime.

Aziz Bytyqi - unë jam që ai në raport me u përfshi sepse komisioni ka pas juridiksion territorial mbi komunën por veprimtaria ka qenë e regjistruar këtu.Nëse nisemi prej këtij parimi ku Prizreni thotë nuk është i regjistruar në Prizren e ne themi që nuk e ka ushtruar veprimtarinë në Suharekë,ai mbetet në pozitë të palakmueshme.Gjithëashtu me këtë çështje ka me u marrë një komision qeveritar dhe e ka kompetencë për krejt territorin e Kosovës.

Urim Suka - për këtë punë është formu një komision dhe kush jemi ne me vendos. Për me fut edhe këtë.A e kemi mandat ne me vendos me fut edhe një tjetër? Unë nuk besoj që e kemi këtë mandat.Çka mundemi ne me bo? Mundemi mos me votu.Mundemi me thirr komisionin që ta shqyrtoj dhe ta bëj pjesë të raportit dhe le ta sjell raportin nesër dhe ne e votojmë.Pse Armendi me shku me marrë atë raport? Secilin qytetar duhet me trajtu barabartë.Nëse ke shku me marrë atë në Prizren,pse edhe kto tjerat ske dal me i marrë?Është gabim qasja.Ju lus që ai qe e propozon një pikë,le të del,le ta elaboron dhe ndoshta disa pyetje nuk i bëjmë fare.Përtej vullnetit që jam për me fut, por skam mandat.

Aziz Bytyqi - nuk është që ne po marrim kërkesa dhe po i fusim ashtu,por kemi të bëjmë me një rast specifik.Ai qytetar nuk po ka mundësinë sot me e realizu të drejtën e tij në kompenzim të dëmit as në Suharekë e as në Prizren.E mora raportin e drejtorit të mirëqen dhe ne në këtë kuptim me përfshi.Prap vlerësimi përfundimtar qenka në dorë të zyrës pranë kryeministrit.

Dardan Berisha - unë realisht e propozova për me fut edhe emrin dhe mbiemrin e këtij fermieri që ju kanë dëmtu 58 bletë.Ju kisha thënë asambleistave të rinjë dhe drejtorave që mos të interferohen në fjalët e Urimit sepse kurrë i kënaqur nuk është.Kjo foltore nuk është për me bo politikë.Unë si asambleist kërkoj edhe një interpretim ligjor prej zyrtarit ligjor që a kemi të drejtë ne me propozu që mos me i humb e drejta e dëmshpërblimit këtij personi të cilit iu kanë dëmtu bletët.Sa i përket konfidencialitetit,ne si asambleist kemi të drejtë secili prej nesh me bo një kërkesë,me iu drejtu komisionit për emër e mbiemër.

Kryesuesi - unë kam pas kontakt me personin sepse ka ardhë te unë në zyrë.Kam bisedu edhe me komisionin.Komisioni ka dal në teren,e ka verifiku që ju ka bë dëmi por komisioni nuk ka pas kompetencë me vlerësu për shkak që dëmi është bë jasht territorit të komunës së Suharekës.Ne duhet me i ndihmu dhe sa kemi të drejtë nuk e di.

Urim Suka - kur po e dëgjoj Dardanin duke fol,po më kujtohen studiot televizive në ato debatet me Kryetarin.

Dadrdan Berisha - është e vërtetë.Debatet i kam pas me të gjithë dhe nuk i kam pas vetëm me Kryetarin Muharremaj.Kryetari Muharremaj e ka fitu mandatin e tretë dhe ne jemi në bashkëqeverisje.Një interpretim ligjor nga zyrtari ligjor ose nga ju Kryesues.Nëse nuk lejohet sot me fut,a kemi të drejtë që seancën tjetër me bë kërkesë siq kemi bë kërkesa të shumta në mandatet e ndryshme për me i ndihmu këtij fermieri?

Avni Bytyqi - ligji për fatkeqësitë natyrore dhe rregullorja e qeverisë së Republikës së Kosovës 17/2024 thotë:komisioni e dorëzon raportin te Kryetari i komunës,Kryetari i komunës e vlerëson raportin nëse konstaton që ka ndonjë mangësi dhe në konsultim me komisionin e korigjon raportin dhe raporti dërgohet në kuvend për miratim.

Kryetari - unë e kam thirr komisioni por komisioni nuk ka pranue sepse nuk kanë të drejtë ligjore.

Armend Krasniqi - komisioni jonë nuk ka pas të drejtë me shku në Prizren sepse kompetencat i ka pas Prizreni.Komisioni i Prizrenit ka dal i ka vlerësu dëmet e veta dhe ka thënë që ky fermer është dëmtu por nuk është i regjistruar në komunën e Prizrenit.E kanë gjet që është i regjistruar në Suharekë dhe ka thënë që kjo dosje duhet me shku në asamblenë komunale në Suharekë për miratim.Në kuadër të kësaj kemi dy emaila nga ministria të cilat e kanë vërtetu saktësisht këtë që e them unë.

Kryetari - unë propozoj që të takohem me Kryetarin e Prizrenit,le të ulen dy komisionet,le ta bëjnë vlerësimin e përbashkët dhe të vijnë në seancën e radhës në Asamblenë komunale.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 9.

Pika 10. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit financiar të ekzekutimit dhe administrimit të buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-dhjetor 2025;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Fadil Hoxha - buxheti total janar-dhjetor i komunës së Suharekës ka qenë 25,503,000.10 kurse shpenzimet që janë kryer për këtë periudhë janë 24,707,487.85. Të hyrat vetanake gjatë kësaj periudhe janë realizu 94.23%. Pjesmarrje më të madhe të realizimit në këto të hyra gjatë periudhës janar-dhjetor janë tatimi në pronë sëbashku me pjesën e vet ku gjatë kësaj periudhe janë realizu 837,150.38€ apo pjesmarrja e saj në të hyra të përgjithshme, si e hyrë është 36.99 bruto në totalin e të hyrave vetanake për vitin 2025. Nga buxheti i përgjithshëm 309,522.41 është pjesë e suficitit. Kjo pjesë prej 309,522.41€ i takon 455.88€ është një pagë të arsimit që u kthy me vonesë, te mallrat dhe shërbimet është 39,342.89€ suficit, te shpenzimet komunale është 15,121.18, te subvencionet janë 263.39 dhe te kapitalet është 254,319.07. Te pjesa e të hyrave që ka mbet pa u shpenzu dhe që duhet të barten për vitin fiskal 2026 janë 14.472 është prej 22-shit dhe 129.273 janë prej 22-shit dhe pjesa prej 592,354.23 është pjesë që ka mbet mbi planin por që janë pjesë e vendimeve të gjobave të trafikut dhe gjykatave dhe pjesa që do të bartet vitin e ardhshëm për shpenzim është 736,369.98. Shpenzimi i projekteve kapitale: buxheti i alokuar sipas granteve 7,555,513.00€ ku ajnë shpenzuar 6,851,000.00.

Sa i përket shpenzimeve të gjykatave sipas kategorive ekonomike dhe fondeve, totali është 3,082,000. Për vitin 2023 janë 608.372€, për vitin 2024 janë 4,133,857 ose në total për tri vite vendimet që i ka pagu komuna janë 7,825,126.86. Te lista e projekteve kapitale, shpenzimet sipas vendimit të gjykatave: Te ndërtimi i sallës sportive në Peqan, buxheti ka qenë 120,000 prej 10-tëshit dhe 20,000 prej 21-shit. Prej 120,000, 100,000 janë vendime të gjykatave dhe realisht nuk është punu asgjë dhe ato 20,000 kanë shkuar suficit. Te pjesa e shpenzimeve sipas njesive buxhetore i keni për secilën drejtori të gjitha llojet e shpenzimeve.

Flamur Bytyçi - ekzekutivi e ka shtu pak lluksin kur po i shoh shpenzimet, sidomos te pjesa e ushqimit edhe pijeve ku për vitin 2025 janë të shpenzuara afër 100,000€. Mjekët dhe infermierët që janë me karitas janë pothuajse 2 muaj mbrapa me pagë. Unë po habitem si keni mundësi ju me shfrytëzu lluks e këndej nuk gjeni hapësirë buxhetore për me i pagu këta. Edhe te pjesa e shpenzimeve te telefonisë mobile, e kam përmend edhe në KPF dhe po më habit fakti se si ka mundësi me u hargju kaq shumë mjete kur dihet fakti se edhe ofertat dhe parapagimet mujore janë më të lira. Vetëm zyra e Kryetarit i ka 5.365€ për 12 muaj ku shpenzimi mujor i bie 447€. Unë e kuptoj që Kryetari e ka telefonin pa limit mirëpo në bazë të asaj që unë e kam, pagesat për zyrën e Kryetarit nuk janë aq sa janë paraqitur në këtë raport. Kërkoj sqarime nga Kryetari dhe Drejtoria e Financave. E përmendi Fadili tatimin në pronë ku sipas planifikimeve që kanë qenë, është realizu në masën 69.28% të planifikimit apo 30.72% më pak se plani buxhetor për vitin 2025. Unë mendoj që ju duhet me marrë për bazë shpenzimin, keqpërdorimin dhe abuzimin me paranë publike që janë duke e bërë.

Fadil Hoxha - edhe në KPF kam thënë që është një vendim i Kryetarit për gjithë punëtorët që i ka zyra e Kryetarit ku bën pjesë Kryetari, Nënkryetari, Kryesuesi e disa zyrtarë dhe besoj që nuk është e huqne, është i saktë shpenzimi.

Flamur Bytyçi - në bazë të dokumentit që unë e posedoj, pagesat e komunës së Suharekës kundrejt operatorit ekonomik janë 13.015€ vetëm për zyrën e Kryetarit, nuk janë aq sa janë të deklaruar këtu.

Fadil Hoxha - janë mbushje të telefonisë mobile që i përdorin zyrtarët. Unë mundem edhe në mënyrë analitike me nxjerr dhe me sjell mbledhjen e ardhshme kush ka marrë, sa ka marrë. Nëse je i interesuar bëje një kërkesë me shkrim.

Kryetari - jo 100 € por as 50€, as 30€ në muaj. Unë punoj me ipko dhe e paguaj privat. Mduket e kemi 40 ose 50€ numrin e telefonit. Të gjitha 2 euroshet për telefon që është e paraparë me ligj për punëtorët e komunës, shkojnë në emër të Kryetarit. Unë në mënyrë zyrtare ka me kërku prej postës vetëm për telefonin tim për vitin 2025 dhe ka me sjell me pa.

Flamur Bytyçi - nuk bëhet fjalë për shpenzimin tënd si Kryetar por si tërësi.

Kryetari - sa i përket ushqimeve, me ndonjë delegacion kur kam dal, përndryshe në dreka asnjëherë nuk dal. Çmimet janë rrit dhe kur organizohet ndonjë iftar, nuk ka çmim më me 8 € ose 10€.

Liridon Fandaj - ky raport nuk është thjesht një dokument teknik. Ai pasqyron saktë se si është qeverisur komuna gjatë vitit të kaluar dhe fatkeqësisht ajo që shohim është një qeverisje pa vizion, pa planifikim dhe pa rezultat konkret për qytetarët. Sipas raportit, të hyrat vetanake të planifikuara në vitin 2025 janë alokuar 100% por janë realizuar vetëm 2,401,442.06€. Me gjoba shuma arrin në 2,993,778.23. Kjo tregon qartë se komuna ka dështuar të realizoj planin e vet financiar. Të hyrat vetanake

janë baza e zhvillimi lokal dhe mosrealizimi i tyre dëmton drejtëpërdrejtë shërbimet publike dhe investimet. 2.Mbi 736.000€ të pa shpenzuara që barten në vitin 2026; 129,273.52 të hyra vetanake të pa shpenzuara,14,742.23 janë mjete të bartura në vitin 2025. 592,354.23 janë të hyrat nëntor-dhjetor.Në total 736,369.98 do të barten në vitin 2026.Kjo është dëshmi e qartë e mungesës së planifikimit dhe paaftësisë për të realizuar projektet në kohë. 3.Projekte kapitale të ngecura 90.68% të realizimit; Nga 7,555,513.53 të alokuara për projekte kapitale janë shpenzuar vetëm 6,851,253.48.

Kanë mbetur të pa shpenzuara 704,260.05.Këto janë veq shifra,janë projekte të pa përfunduara,kanalizime të ngecura,shkolla pa investime dhe projekte të premtuara dhe të pa realizuara 4. Donacione dhe grande të performacës vetëm 35.51 realizim; Nga 526,916.94 të alokuara,janë shpenzuar vetëm 187,098.91.Kjo tregon se kur edhe paratë vinë të gatshme,qeverisja nuk arrin ti përdor dhe kjo dëmton imazhin e komunës,besueshmërinë e atyre që janë si donatorë. 5.Spenzimet komunale 96.8% realizimi i buxhetit total.Nga 25,503,000 të alokuara janë shpenzuar 24,707,487.85.Edhe pse përqindja duket e vogël në vlerë monetare,kur kjo përkthehet në projekte janë qindra e mijëra euro.Raportet tregojnë qartë se disa drejtori nuk kanë përmbushur as minimumin e detyrës.Urbanizmi dhe planifikimi ka realizuar 54.34% të hyrave krahasuar me vitin e kalaur.Katastri ka realizuar 93.75% të planit.Kultur,Rini,Sport ka realizuar 53.74% të planit.Shërbimet Publike kanë shpenzuar 88.71% të buxhetit krahasuar me vitin 2024.Ne si opozitë do të vazhdojmë të kërkojmë llogari,do të kërkojmë transparencë dhe do të kërkojmë që çdo euro e qytetarëve të shpenzohet me përgjegjësi dhe në kohë.Qytetarët meritojnë një qeverisje që punon,jo një administratë që arsyetohet.

Kryetari - për vitin e kaluar jemi komuna e katër në nivel të RKS-së.Në 2024 kemi qenë komuna e tretë dhe kemi marrë grand 930 mijë euro.Të hyrat i kemi rrit.Është e vërtetë që barten por mjetet që mbledhen muajin nëntor-dhjetor nuk shpenzohen,barten.Te performanca paratë nuk shkojnë suficit por barten,është duke u ndërtu objekti i Eko Therandës në Shirokë.Janë pa shpenzuar 380.000€ për arsye sepse janë nënshkruar kontrata me vonesë,një lëndë ka shku në OSHP dhe është vonu.Gati 3 milion euro kemi bërë të hyra.E ceket që janë shpenzu investimet kapitale mbi 90%.

Liridon Fandaj - Kryetar,ajo që ke dal e treta a e dyta,ne nuk po themi në bazë të shifrave dhe raportit financiar që ka ardhë këtu.Te pjesa e investimeve kapitale është vërtetë me vlerë 90.68% por i ke disa investime kapitale qe ia ke marrë mjetet e kanë shku në përmbarues e nuk janë këtu me shifra por raporti del në rregull.A i ke realizu?I ke projektet kapitale që i ke bartë që 4 vite me të njetat emra.

Kryetari - ajo çka është ligjore, përmbaruesi nuk pyet dhe ka fillu me marrë edhe këtë vit dhe sa ka me marrë nuk e di as vet.

Urim Suka - Gjatë viti 2025 kemi pas përpjekje masive të pushtetit që të promovojë projekte duke bërë përpjekje që të paraqesin punën e tyre me punën e tyre me suksese të mëdha.Po ashtu edhe ne si opozitë në baza dittore kemi bërë përpjekje të tregojmë realitetin me fakte konkrete për problemet që ishin gjatë gjithë viti 2025.Kjo përpjekje si e pushtetit ashtu edhe e jona si opozitë mund të shihet si përmbushje e roleve tona që kemi marrë nga qytetarët.Mirëpo sot përtej fajlëve e argumenteve tona kemi një raport që flet vet.Në këtë raport kuptohet një dështim i jashtëzakonshëm i kësaj qeverisje për vitin 2025.Në këtë raport figuron që këtij pushteti i kanë mbetur pa shpenzuar rreth 1.4 milion euro gjatë këtij viti. 309,502.00 € janë kthyer suficit dhe këto mjete më nuk mund të përdoren.341,994.00€ janë mjete që nuk janë shfrytëzuar e që kanë qenë donacione.144,000.00€ janë të hyra vetanake të pa shpenzuara ndërsa 592,354.00€ janë të hyra vetanake për muajt nëntor-dhjetor që bashkë me të hyrat vetanake të pa shpenzuara për vitin 2025 do të barten për shpenzim për vitin 2026.Totali i bartjes për vitin 2026 është 736,369.00€.Gjithë këto mjete të pa shpenzuar kur i shton edhe 3 milion euro të humbura nga veendimet gjyqësore,e shoh qartë dështimin e jashtëzakonshëm që kjo qeverisje ka pas gjatë viti 2025 dhe mungesën e implementimit të plot projekteve në interes të qytetarëve. Mes propagandës masive të pushtetit për sukses dhe kritikës së vazhdueshme tonë si opozitë për dështim,kemi këtë raport që ky pushtet e ka përgadit ku shihet qartë se dështimi është i jashtëzakonshëm dhe këtë duhet ta dinë të gjithë. Mbi këto shifra e këto dështime në këtë raport figurojnë plot pozicione ku shkruan diçka tjetër e në fakt është realizu diçka tjetër.Për këto çështje kemi fol në vazhdimësi dhe të gjithë besoj jeni në dijeni,prandaj ne nuk e mbështesim këtë raport.

Uroj të reflektoni sepse dëmi që po shkaktohet për projektet,për punëtorët komunal e qytetarët është i jashtëzakonshëm.Gjithë këto aktakuza janë rezultat i kësaj pa përgjegjësie që ju ka përcjell gjatë gjithë kohës.Këto aktakuza nuk na bëjnë nder dhe kërkojnë reflektim të shpejtë,përndryshe rrezikohet që mandati të merret para kohe nga drejtësia.Ajo që më shqetëson edhe më shumë është fakti që unë kërkoj që të zbardhet ajo që ka ndodh në vitin 2025 me formimin e komisionit dhe çuditërisht po bëheni bashkë shumica e asambleistëve për mos me leju m'u zbardh ajo çka ka ndodh.Uroj një ditë të reflektoni,ta formojmë këtë komision dhe ti analizojmë bashkarisht këto gabime me qëllimin e vetëm që ti përmirësojmë në vitin vijues.Uroj që kritikën tona mos ti kujtoni si zë opozitar por ti dëgjoni dhe

argumntet për ato që themi dhe të vendosni mbi bazën e argumenteve,jo mbi bazën kush po flet dhe prej cilit kënd po qyrr.

Astrit Salihu - në raportin financiar unë desha të ndalem në një investim të shërbimet kumlturore ku thuhet që është bërë ndërtimi i minifushës së futbollit me bar sintetik në fshatin Mushtisht në vlerë 10.000€ dhe kjo 10.000€ është pagu.Ku janë investuar këto 10.000€ sepse në teren kjo nuk ka ndodh?

Kryetari - bëj kërkesë zyrtare,kërko qasje të financieri dhe tregon ku kanë shku 10.000€.

Nexhat Ramadani - ajo që është më shqetësuese janë 309,000.00 të cilat nuk kthehen më,e për të cilën shpeshëherë qeveritë e kaluara tonat janë kritiku.Çështjen e realizimit e diskutoi edhe Liridoni dhe nëse i sheh këto tabela,del që krejt realizimi i buxhetit për investimet kapitale dhe në përgjithësi është mbi 90%.Është mirë mbi 90% por problemi është te cilësia e shfrytëzimit.Ne i kemi dy tabela,një tabelë është me të dhënat e të gjitha kategorive që i ka marrë mjetet gjykata,ku prej investimeve kapitale janë marrë 2,142,000.28 ndërsa në listën e investimeve kapitale ku janë shpenzuar dalin disa projekte të cilat janë të shpenzuara krejt.Shifet projekti për ndërtimin e impianteve për ujëra të zeza në Dubravë dhe Sllapuzhan nga 80.000€.A janë shpenzuar këto mjete për impiante apo këto mjete janë marrë nga përmbaruesi? Nëse janë të marrura nga përmbaruesi,a i keni fut në listë sepse lista të cilën i keni paraqit atje nuk i përfshin këto.Unë sa kam informacione nuk janë bo këto investime ndërsa figurojnë si të shpenzuara.Është dasht me i bo bashkë te mjetet të cilat janë marrë prej denimeve dhe jo me i vendos si të realizuara.Si mundet me votu një raport një asambleist që pa i vënë gisht kokës dhe e ka votu dikush më herët,p.sh në Nepërbisht ju e keni miratu me tjetër emër e ndërkohë keni bërë tjera rrugë atje e këtu e keni vendos ashtu qysh është me vendim të Asamblesë.Kjo është cilësia e shpenzimit.Nuk është vetëm një por është një varg i madh i projekteve që i keni bërë kështu.Ky vendim nëse këtu miratohet,në një formë është rast edhe për prokurori.Ne e kemi diskutu edhe atëherë,kemi dhënë edhe sugjerime të arsyeshme kur është miratu buxheti për vitin e ardhshëm dhe pse nuk e kemi votu,ju kemi thënë ti hiqni sepse keni projekte të cilat i keni pas vitin e kaluar por nuk i keni përmirësuar.E di që në një seancë kur PDK-ja ka propozu disa projekte me qëllim të votimit të buxhetit,ju e keni qu buxhetin edhe pa ato projekte që i keni votu e rrugët ia keni bërë.Ky është raport jo i mirë,që mashtron,nuk është real dhe nuk mund ta votoj.Nëse votohet,ne do ta ngritim si çështje.

Kryetari - në Dubravë është kontratë dy vjeqare dhe është duke u punu impianti i ujërave të zeza.Në Sllapuzhan nuk është duke u punu sepse s'kan lënë qytarët.

Fadil Hoxha - te ndërtimi i fushave me bar sintetik,e ke te tabela faqe 22 vendimet e gjykatave dhe e ke në faqe 24 dhe të them që është vendim i gjyaktës.

Astrit Salihu - unë e thash që është faqe 20 ndërtimi i mini fushës së futbollit me bar sintetik,buxhet i shpenzuar.

Fadil Hoxha - a është bo apo jo unë nuk e di.Te 22-shi i ke të gjitha emrat që janë bo me vendime të gjykatave.Impianti i ujërave të zeza në Sllapuzhan e ke 80.000 që është shpenzu dhe e ke te vendimi i gjykatave në faqe 22.Në faqe 22,23 dhe 24 janë të gjitha projektet që janë shpenzuar sipas vendimit të gjykatave me emra.

Labinot Halitjaha - Urimi dhe Liridoni që diskutuan janë jo shumë të drejtë dhe jo racional në kuptimin e bartjes së të hyrave.Nëse ju i menaxhoni financat,që e diskutuat nëntorin dhe dhjetorin ku thatë që ka shku suficit,a mundenu me shpenzu?Ju sot e transmetuat në publik që është bartje e faktikisht nuk është bartje.Duhet me ditë ligjin dhe me diskutu këtë temë dhe jo me qenë jo racional me publikun.Tema të shërbimet publike ku diskutoi Nexhati për shpenzimin e buxhetit ku kanë shkuar dikund tjetër dhe janë me kode tjera,ne nuk mund ta ndërrojmë kodin.Me atë kod që janë planifiku,atë kod duhet ta vendosim.Nëse doni diçka më shumë mund të bëni kërkesë në dokumente zyrtare.

Liridon Fandaj - nuk është hera e parë që janë bartë por nuk po them për nëntor dhe dhjetor. 129,273.52 të hyra vetanake janë të pa shpenzuara.Kjo thotë që planifikimin që e ke pas të të hyrave vetanake,nuk i keni shpenzu.I ke 14,742.00 mjete të bartura të vitit të kaluar,që kur ti bart ato duhet me planifiku me i shpenzu.Unë shumë mirë kuptoj që nëntor-dhjetor nuk mudesh me i shpenzu.

Urim Suka - e kuptoj asambleistin që sapo e ngriti fjalën.A e din sa e vështirë është me qenë në rolin e një asambleisti të këtij pushteti kaq të papërgjegjshëm.Ajo që nuk të kuptoj është që e devijove krejt atë që e thashë. 592,000.00 e përmenda siq janë të hyra nëntor-dhjetor dhe bashkë me 144,000.00 barten.Nuk ke ndëgju fare dhe more me mbrojtë pushtetin.Vërtet ju kuptoj sepse jeni në rolin më të vështirë,ju keni me votu këtë raport.

Nexhat Ramadani - atë që e tha Labinoti e kemi të qartë sepse kam një përvojë por unë thashë që problemi kryesor është cilësia e shpenzimeve.Në ligjin për menaxhimin e financave publike është një miratim,neni 27 thotë: asnjë investim kapital nuk mund të bëhet pa miratim publik.Edhe ti është dasht me reagu Labinot dhe me thënë që kjo është në kundërshtim me ligjin kur ta ka sjell naj vendim sepse

edhe ti mban përgjegjësi si zyrtar i financave. Kryetari po thotë bëni kërkesa por kur t'vje një pikë e raportit këtu, duhet me qenë krejt administrata dhe me na dhënë sqarime.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 10.

14 për, 11 kundër, 1 apstenim, Miratohet pika 10

Pika 11. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit të komisionit për mbikqyrjen e kontratave në zonën industriale në Shirokë;

Kryesuesi - elaboron pikën dhe hap debatin.

Flamur Bytyçi - e përgëzoj komisionin që e ka bërë një punë të jashtëzakonshme. Edhe në KPF e kam kërku një raport ku Kryetari i ka dhënë autorizim shtesë komisionit paraprak. Kryetar cila është vendimmarja juaj në bazë të rekomandimit që ju ka dhënë ky komision? Ky komision ju ka rekomandu me marrë masa kundër këtyre që e kanë keqpërdorur zonën industriale, ku shumica prej tyre asgjë s'kanë bërë që 10 vite. Mbas 10 viteve e keni themeluar një komision dhe kur e keni themeluar komisionin, ju ka ardhur raporti dhe prap se prap pas një viti asnjë masë nuk e keni marrë. Tash po doni me marrë një vendim me ju dhënë afat edhe një vit shtesë. I keni 10 kontrata të shkëputura. Qysh dojmë me i dhënë afat dikujt që e ka kontratën e shkëputur? Për 9 vjet mandat ju i keni shkëput vetëm 2 kontrata. Pse keni bërë seleksionime? Edhe mosveprimi është vepër penale dhe këtë duhet me ditë Kryetari, drejtori që ka qenë në atë kohë dhe drejtoria e Financave, e ju se keni qu te përmbasuesi askënd. Çka ka ndodhur me vendimin që i keni dhënë autorizim shtesë i cili është nënshkruar vetëm prej dy personave? Nëse kemi një raport, ku është raporti. Unë mendoj që ne nuk duhet me i dhënë afat shtesë askujt që nuk i ka përmbushur kriteret. Kërkoj nga të gjithë ju me reflektu. Kërkoj që këtë vendim me kthyer mbrapa sepse nuk mundesh ligjërisht me i dhënë afat dikujt që e ka kontratën e shkëputur. Për këtë punë e ke mbështetjen e plotë të partisë tonë dhe nuk ka nevojë me u frigu prej askujt. Për deri sa ti i ke 30 kërkesa në rend të protokolluar, çka dojmë me i thënë atyre? Ne nuk po jemi në gjendje si komunë me e rregulluar zonën industriale e po kqyrni me bo zonën industriale në Biraq. Ne e kemi pas edhe një mundësi të Damperi dhe nuk e keni shfrytëzuar. Është dasht me bo këmbim prone pavarësisht që nuk ka qenë në pronë të komunës, dhe është dasht me ja dhënë në Biraq e me marr atë pjesë për me shfrytëzuar bizneset. Kam një kërkesë e cila është në emër të 30 bizneseve të cilët e kanë kërku një parcelë dhe këtë çështje konsideroj që duhet me marrë shumë seriozisht.

Kryetari - është e vërtetë ajo që the por përgjegjësinë e marr për çdo gjë prej 1 janarit 2018. Këto prona 2016 dikun janë 10 që kanë punuar. Kam kërku një komision më herët, nuk ka dasht asambleja komunale e që ka pas obligim. Ku ju konvenon juve keni qef me hy, kur s'ju konvenon s'do me hy. Vendosim me ja marrë ato prona dhe i vendosim në ankand por dijeni që dikush ka investuar aty 2 milion euro, dikush 1.5 milion, dikush 800 mijë euro. Unë kisha thënë ta votojmë për një vit, të formohet komisioni. Nëse i kryejnë punët, mirë, nëse s'i kryejnë atëherë duhet me gjet një ekspert të licensuar të ekonomisë me dal me vlerësuar sa është investimi sepse toka nuk shitet asnjëherë por jepet në shfrytëzim.

Flamur Bytyçi - Kryetari akuzoi pak që nuk kemi pranuar me qenë pjesë e komisionit. Po është e vërtetë. A e din arsyen pse Kryetar? për arsye sepse rregullorja për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme neni 27 thotë: drejtoria përkatëse e komunës mbikqyr realizimin e kontratës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës. Drejtoria harton raportin për historinë, zbatimin e planit dinamik si dhe realizimin e kontratës si tërësi duke i rekomanduar Kryetarit të komunës marrjen e masave përkatëse në rast të mospërmbushjes së kontratës. Pika 3. Kryetari i komunës pas shqyrtimit të raportit merr masa ndaj investitorit me qëllim të përmbushjes së kontratës. Kryetar a je përgjegjës ti dhe Armendi? Ju e keni nënshkruar kontratën sepse kuvendi nuk nënshkruan kontrata. Ne vetëm e hedhim në votim për me dhënë në shfrytëzim dhe nuk kujdesemi a e ka respektu apo jo kontratën, ti e ke obligim.

Armend Krasniqi - aty i kemi 54 kontrata të cilat pothuaj janë aktive. Zona industriale ka filluar prej një zone e cila ka qenë krejt lloq. E kanë filluar shumë mirë dhe ka rezultuar si një zonë që të gjitha qytetet tjera e gjelezojnë. Me kalimin e kohës kanë rrjedhur disa problematika të cilat nuk janë analizu nga komuna. Ka probleme të 2015 por me një vendim Sali Asllanaj atëherë ka rekomanduar me i shkëput 18 kontrata në zonën industriale. Në 2016 ska pas komision që i ka monitoruar, s'ka pas drejtor që e ka monitoruar zonën, s'ka pas asnjë indikator që ka marrë hapa të mëtutjeshme se si duhet të veprohet. Pra problemi ka filluar qysh atëherë. Disa nga kontratat të cilat i ka dhënë rekomandim me i shkëput, sot janë kontrata të cilat operojnë miliona euro. Këtu ka probleme të cilat janë akumuluar shumë dhe në përfundim kemi ardhur me kriju një komision, komisionin e asamblesë komunale. Komisioni i asamblesë komunale nuk ka dasht me marrë një barrë të rëndë. Ne sëbashku e kemi formuar një komision ku unë kam qenë kryesues i këtij komisioni dhe në fund kemi ardhur me një përpilim të raportit. Raporti jonë me siguri ka

pas edhe mangësi sepse nuk kemi pas kompetenca. Ka kontrata kur janë të shkëputura, çka me vepru aty? Çështja e pronës është jashtëzakonisht çështje me problemet më të mëdhaja në nivel të Kosovës si çështje e brendshme për shkak sepse në Suharekë zyrtarisht figurojnë 1085 uzurpime ku 100 i kam liru. Është e vërtetë që duhet me gjet një zgjidhje në zonën industriale dhe përmes kësaj zgjidhje mos ti dëmtojmë as bizneset. Është mirë me votu edhe për një vit që problemet që janë akumuluar që 10 apo 15 vite, ti japim një kahje ku mundemi me kriju një alternativë e cila krijon zgjidhje.

Flamur Bytyçi - Armendi përmendi që njërit prej tyre që iu ka shkëput kontrata ka investu milionësh, unë në raport nuk e shoh që është cekë. Çështja e dytë që atyre që po thua ti, i ke dhënë njëherë në 2019 një vit kohë e tash po do me ia dhënë edhe një vit kohë. Kujt po do me ia dhënë?

Armend Krasniqi - të gjitha bizneseve.

Flamur Bytyçi - ti po mendon që po i bën favor dikujt por ndoshta 30 tjerë që janë duke t'prit n'komunë. Ama raportin që ty t'ka autorizuar Kryetari ekstra, çka keni bo ju?

Liridon Fandaj - nga raporti në total janë 63 biznese, 57 në zonën industriale dhe 6 në Agrozonë. Biznese aktive 33, biznese pjesërisht aktive 4, jo aktive 26, kontrata të shkëputura ose pjesërisht të shkëputura janë 7 dhe biznese pa leje ndërtimore ose pa proces legalizimi janë 17 raste. Nga ato kontrata që shihet dhe që i kam marrë edhe zyrtarisht, në kontratë shkruan veprimtari tjetër ndërsa në teren ke veprimtari të ndryshme. 23 vite nga 2010-ta që kanë kontratë aty, mos me pas as leje dhe as legalizim, nuk është në rregull. Nuk është në rregull me thanë Kryetari që unë e marrë përgjegjësinë veç pjesën tjetër, sepse ky e udhëheq komunën e Suharekës dhe duhet me respektu ligjin për secilën. Unë rekomandoj që të formohet një komision për ata që kanë bërë investime, me bo vlerësimin dhe ato prona nëse nuk kanë mundësi me i zhvillu, me i vendos në ankand dhe me dhënë në atë vlerë të investimit që mos me i dëmtu ata që kanë ngec. Por me ia vazhdu edhe një vit dikujt që e ka kontratën e shkëputur ose dikush që i ka 15 mijë euro borgj e i shfrytëzon 12 hektar aty.

Sanie Kuçi Rexhepaj - e përgëzoj komisionin për punën dhe përgaditjen e këtij raporti informues lidhur me gjendjen në zonën industriale në Shirokë dhe Samadraxhë. Si raport ka mujt me qenë edhe ma profesional. Ka pikëpyetje dhe paqartësi në shumë çështje. Gjithëashtu duke marrë parasysh që ky raport po protokolohet dhe po vjen zyrtarisht në kuvend, gabimet teknike janë tejet jo profesionale sa krijojnë në shumë raste edhe konfuzion. Vitet në disa raste janë të shënuara me 5 numra. Vlerat investive thuhet, p.sh për një parcelë të caktuar 300.000, që ajo vlerë ku vendoset pika lexohet treqind e nuk lexohet treqindmijë ashtu si keni dasht me pasqyru vlerën investive të atij biznesi për shkak se mas pikës zerot nuk kanë vlerë. Gjithëashtu edhe simboli monetar po mungon. Ndonëse i vonuar si raport si pasojë e neglizhencës së drejtorive dhe zyrës së Kryetarit. Nëse ky raport ishte hartuar me kohë, nuk do e kishim këtë pasqyrë që e kemi sot. Zona industriale përfaqëson një aset strategjik për zhvillimin ekonomik të Suharekës. Ajo duhet të jetë motorr i punësimit, investimeve dhe rritjes ekonomike lokale, andaj çdo kontratë e papërmbyshur dhe e parespektuar nuk është vetëm çështje administrative por është çështje e interesit publik. Zona industriale në Shirokë është ndër zonat më të zhvilluara në Kosovë dhe këtë e kemi ndëgju vazhdimisht dhe e dëgjuam edhe sot. Por kur lexohet ky raport me aq shumë parregullsi, me aq shumë ndërtime pa leje, me aq shumë borgje ndaj qiradhënësit, me aq shumë ndërrime të destinimeve dhe ndërrime të shfrytëzuesve të parcelës, lind nevoja serioze për një reflektim institucional dhe përf forcim të mekanizmave të monitorimit dhe zbatimit të kontratave. Te pjesa e monitorimit dhe zbatimit ka kohë që keni dështu. Raporti nga komision është dorëzuar te Kryetari në prill të vitit të kaluar por deri më tani Kryetari nuk ka ndërmarrë as edhe një veprim bazuar në këtë raport. Krejt çka ka ndërmarrë është vendim mbi autorizimin dhe obligimin e të njejtit komision që të merr masa përkatëse ndaj investitorëve me qëllim të përmbushjes së kontratës. Vendimin e kemi në fund të këtij raporti dhe sipas asaj çka shohim vetëm dy anëtarë të këtij komisioni kanë pranuar vendimin. Anëtarët e tjerë që nuk e kanë pranuar, kanë pas plotësisht të drejtë. U përmend edhe çështja ligjore që e citoi edhe Flamuri në qarkoren që rrjedh nga ligji për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale neni 27. Pra marrja e masave nuk i takon një komisioni por Kryetarit të Komunës. Përmes këtij veprimi të zyrës së Kryetarit po e shohim n'praktikë të përsëritur të ikjes së përgjegjësisë. Je Kryetar komune për të tretin mandat dhe nuk mundesh edhe për të tretin mandat me kqyr me i ik përgjegjësisë në zonën industriale. Të sugjeroj me zbatu refrenin tënd të famshëm që thu: unë nuk shkruaj po veq nënshkruaj. Por në këtë rast në zonën industriale nuk ke guxim as me shkru e as me nënshkru. Nuk është rasti i vetëm në zonën industriale. Një praktikë e tillë është përsëritur gjatë gjithë qeverisjes tënde. Si rezultat i këtij menaxhimi sot komuna e Suharekës është ndër komunat më të atakuara nga prokuroria, e veqmas këto dy mandate të fundit një pjesë e madhe e zyrtarëve në komunën tonë janë me aktakuza të ngritura, drejtor të dënuar, zyrtar të dënuar e shumica e drejtorive për momentin punojnë me staf të përgjysmuar. Andaj marrja e masave të takon ty Kryetar. Por në këtë fazë që jemi e duke e parë lëmshin që u kriju në zonën industriale ndër vite, propozimi im është që me hartu një plan të mirëfillt të

veprimi. Përmes të një plani të veprimit mendoj që duhet të bëhet kategorizimi i kontratave në bazë të problematikave dhe secila të përcaktohet në kategorinë e vet. Në këtë formë mundësojmë veprime të njëjta në bazë të kategorive dhe jo për dikë favor e për dikë disfavor. Përcaktohen afate konkrete për përmbushje të obligimeve, të bëhet trajtimi i borgjeve, të bëhet trajtimi i ndërtimeve pa leje dhe i ndërrimeve të destinimeve. Në rast të mosveprimit të inicohen procedurat përkatëse për ndërpreje kontrate dhe rikthim të parcellës në funksion publik. Në secilën fazë kuvendi duhet të jetë i njoftuar duke garantuar një proces transparent dhe llogaridhënës.

Nexhat Ramadani - unë e kuptoj që kjo është një pikë e ndieshme dhe sikur e thanë edhe disa të tjerë që ky është një problem që ndoshta është përcjell. Mirëpo nuk duhet kurrë me u arsyetu që dikush s'ka bërë dhe unë sot mos t'bëj kur dihet që faktikisht përgjegjësia i bie ekzekutivit, Kryetarit, drejtorisë e cila e monitoron dhe e rekomandon, i jep raport Kryetarit dhe Kryetari duhet me marrë masa. Ka një vit që është bërë ky raport dhe nuk keni marrë kurrfarë masa dhe unë e di që nuk është e lehtë por shumë mirë Sania i paska precizuar disa këshilla, rekomandime të cilat faktikisht duhet me i vlerësu sepse është në frymën me iu ndihmu si me zgjidh këtë problem por jo me i hudhë sepse një vendim i tillë në një formë ndoshta është e kundërllogaridhëse. Ne mundemi të formojmë komisione por s'jemi kompetentë sepse u tha me pikat sipas ligjit cilat janë përgjegjësitë e Kuvendit dhe cilat janë të Kryetarit. Andaj mirë e tha Sania që ti hyhet kësaj pune me një plan të qartë. Në një formë nuk ka më tolerancë dhe nuk janë të lehta m'u marrë vendime të tilla por duhet me ia fillu. Është hera e parë që ka ardhë një raport dhe unë e përgëzoj komisionin për raportin me gjithë naj të metë. Kryetar ajo që duhet tani nuk është me hudhë përgjegjësinë diku tjetër sikur që e pash vendimin e fundit që tha Falmuri, por ajo nuk ka të bëjë me punë shtesë por je mundu sipas këtij vendimi që përgjegjësinë e marrjes së masave me ia hudhë komisionit që e ka hartu e që nuk është logjike. Të drejtën për me ia vazhdu edhe një vit e ke ti pa kurrëfarë problemi, pse duhet kuvendi me marrë? Në një formë edhe ne si kuvend nuk është që s'jemi të interesuar me të ndihmu sepse është diçka që është trashëgu por ju si Kryetar për një kohë të gjatë nuk keni marrë kurrëfarë mase edhe përkundër asaj që tash e ke një raport dhe je i obliguar me marrë masa. Andaj përvishju punës, bën plan të veprimit, analizo të gjitha kontratat me rregull dhe çka ka nevojë Kuvendi që është në kompetencë të kuvendit me të ndihmu me zgjidh këtë problem, ne jemi në dispozicion, por jo për çështjet të cilat nuk janë kompetencë e jona.

Urim Suka - dua të ndërlidhem me të gjitha ato që ju sapo thatë. I kuptoj vështirësitë dhe problemet që janë grumbulluara me vite dhe e di mbi bazën e informatave që kam dhe është shumë e nevojshme që me provu çka mujna me bo ma mirë të gjithë bashkë pa marrë parasysh pozicionet dhe rolet që kemi. Edhe ne si LDK jemi për me provu çka mujna me dhënë kontributë që me ndodh diçka e mirë edhe për ato biznese. E dëgjova me vëmendje Kryetarin dhe ndër tjera tha një fajli që mua më pengon shumë. "o asambleista qysh doni ja bëj". Kurrë s'un ja bojna qysh dojna. Ne e kemi një fushëveprimtari të rregulluar me ligj qysh duhet me ia bo. Me ligj është rregulluar që ne japim pëlqime, formojmë komisione dhe mbi bazën e rekomandimeve të atyre komisioneve ne marrim në fund vendime për këto rekomandime dhe japim në shfrytëzim. Kryetari i komunës sipas ligjit është dasht me raportu çdo 6 muaj për ecurinë e kontratave por kurrë s'ka raportu në këto 8 vite në këtë kuvend. Ne sot e kemi një raport dhe në raport vërtetohet me atë çka keni shkruar ju, që nuk janë marrë as vendime sipas ligjit. E keni shkel ligjin. U tha që mundemi me pas përqamje edhe përmes firmave por probleme edhe kështu me i lanë, ka. Më mirë le të ka përqamje se me shkel ligjin. Sikur të ishte një Kryetar që ka ardhë tash në mandin e parë dhe kur e kishte sjellë këtë vendim për me i dhënë edhe një vit shtesë, e kisha mirëkuptu, e kisha pas një lloj përgjegjësie që po don çështjet që janë mbledh deri tash, me i kthi në ligj dhe me marrë vendime që atë zonë me bo sa ma funksionale. E kisha kuptu dhe e kisha votu për. Ka 8 vite Kryetar, asnjë vendim nuk e ke marrë dhe vjen këtu e thotë që ne ta marrim vendimin që ti japim edhe një vit kohë. Jo, është shumë e padrejtë. Është e padrejtë ndaj bizneseve. Pas raportit që ju e keni lëshu aty ka që s'kanë leje ndërtimore, aty janë grumbullu borgjet. Aty ka biznese që kanë marrë pronë dhe nuk janë aktive. Pse po i lejoni ato me funksionu? E tha Flamuri që janë 30 biznese që po presin. Nëse atje dikush ka ndërtu dhe tash nuk është duke bërë asgjë dhe të tjerët po presin, pse na duhet me dhënë edhe një vit? Ku është trajtimi i barabartë ndaj bizneseve? Propozimet e Sanies janë konkrete, duhet plan veprimi. Si LDK nuk jemi për me ndëshku asnjë biznes dhe jemi krenar që e kemi fillu atë zonë. Jena me i mbështet, jemi me i dhënë edhe kohën nëse ka nevojë por jo me i dhënë kohë paushall edhe një vit kur që 8 vite e kanë pas ata kohën dhe s'kanë marrë asnjë veprim. Ju lus ta trajtoni këtë vendim me seriozitet, ta tërheqim këtë vendim, ta bëjmë një plan veprimi, ta rregullojmë mirë këtë çështje. Është detyrë e Kryetarit të komunës kjo dhe ne vetëm mundemi me prit raportin tënd si Kryetar sepse e ke me ligj.

Dardan Berisha - unë mendoj që këtë eufori dhe këtë entuziazëm të cilën po dojmë me e ndërtu ne sot, ta lëmë pas një vit dhe ta shohim çka po bëhet. Unë e di që bashkëpunimi ndërmjet ekzekutivit dhe

legjislativit dhe ndërmejet bizneseve konkretisht sektorit privat është çelësi i suksesit për të cilën ne sot jemi të thirrur këtu për me i ndihmu këtyre bizneseve. Secili prej nesh që del në foltore dhe jemi krenu në të ardhmen dhe vazhdojmë të krenohemi me bizneset të cilat operojnë në zonën ekonomike në Shirokë. Realisht e përshëmdes komisionin për punën dhe aktivitetin që e ka zhvillu gjatë kësaj periudhe. Ajo që më ndryshon mua dhe për çka dola me folë unë sot është faqja e parë. Dua ta dëgjoj edhe nga zyrtari ligjor që nëse ne sot e votojmë një vendim të tillë që me ju zgjat këtyre bizneseve dhe me u pajis me leje ndërtimi dhe m'i ushtru aktivitetet e tyre ligjore, pas këtij vendimi kujt i takon që me i marrë hapat e mëtutjeshme? Unë e them sinjerisht që çdo vendim që vjen në Asamble me ju shkëput, unë si asambleist nuk e votoj shkëputjen e asnjë kontrate të asnjë biznesi.

Avni Bytyqi - shumë parafolës e folën çështjen e kompetencave dhe ndarjes së përgjegjësi të organeve. Ligji për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës si dhe rregullorja, shumë qartë e përcakton çështjen e menaxhimit të pronës. Janë tri faza ndarazi. Faza e parë është dhënia në shfrytëzim e pronës publike që është kompetencë e kombinuar mes kuvendit dhe ekzekutivit. Faza e dytë është faza e mbikqyrjes së kontratave e cila është ekskluzivisht kompetencë e ekzekutivit, e komunës dhe faza e tretë është faza e ndërprerjes së kontratave që është kombinim i organeve të përbashkëta. Kryetari i komunës i rekomandon kuvendit vendime të cilat i ka miratu kuvendi dhe i ka dhënë në shfrytëzim afatgjatë, paraprakisht të shfuqizohen mbi bazën e rekomandimeve që ju kanë dhënë dhe kuvendi ka për obligim që Kryetarin ta autorizojë dhe njëherit ta obligojë që kontratën ta ndërprejë me operatorin që kuvendi ia ka ndërpre kontratën. Ky vendim që ju keni para vete nuk ka ndonjë bazë të mirëfilltë ligjore për ta vazhduar këtë procedurë për arsye se asnjë dispozitë e ligjit për dhënie në shfrytëzim, as e rregullores nuk e jep këtë kompetencë. Sa i përket kush ka me zbatu nëse miratohet, është në vullnetin dhe dëshirën tuaj dhe në bazë të mandatit tuaj, ta votoni apo mos ta votoni. Nëse ky projekt-vendim miratohet, neni 3 e specifikon shumë qartë kush ka me zbatu.

Visar Kuçi - fillimisht kur e kemi marrë vendimin si komision prej Kryetarit ndoshta edhe ne kemi hezitu si komisionet e kaluara që do të jetë një punë e vështirë, por besoni kur ja kemi nis punës e kemi zgjedh rrugën e drejtë dhe kemi thënë që kemi me pasqyru gjendjen e zonës industriale ashtu siç është. Zona industriale në Shirokë ka fillu dhënien e parcellave afërsisht në vitin 2006-2007. Është një zonë industriale që ka pas një plan rregullues, ka qenë e licencuar. Këto prona janë dhënë në disa forma. Fillimisht parcellat janë dhënë përmes qendrës së biznesit që ndoshta s'ka pas ligj apo ka qenë ligji asi soji që kanë marrë edhe me një letërnjoftim. Pastaj ka kalu dhënia e zonës industriale përmes prokurimit publik. Ligji për dhënie në shfrytëzim tash e ka rregullu këtë çështje dhe dhënia e pronave është dhënë përmes komisionit, i formuar prej asamblesë. Mua më vje mirë sepse të gjithë parafolësit këtu e dhatë mendimin për me zgjidh këtë problem. Pse mu dhënë ky afat 1 vit? Kemi biznes që ndoshta që dikund në raportin tonë kur e kemi bërë formularin i ka pas 16 pika që i ka plotësuar, kemi biznes që ndoshta i ka 100 punëtorë, i ka plotësuar pikat por nuk ka leje ndërtimore. Tani ekziston ligji i legalizimit dhe me vetëdijësu atë biznesi që brenda një vtrie m'i thanë të aplikojë për legalizim dhe ti i plotëson 100% kushtet e kontratës që e ke. Ose ka biznes që 0% e ka respektu kontratën dhe nëse ne i japim afat 1 vit atij biznesi, jam i sigurt që s'ka me mujt me i plotësuar edhe investimet. Një komision në 2015-të që e cekti Armendi e që po themi që janë shkëput kontratat, nuk janë shkëput kontratat të plotëfuqishme sepse komisioni i atëhershëm i ka obligu me nënshkru një deklaratë qiramarrësit në Z.I.

që në afat prej 365 ditë nëse ti nuk i plotëson këto investime, po hek dorë nga prona. Ka biznes që i ka plotësuar ato kushte por as biznesi nuk e ka sjell një raport në drejtorinë përkatëse por as komisioni nuk ka shku te ai pas 1 viti me pa se a i ka plotësuar kushtet. Çka ka ndodh? Dikush i ka dërgu në Drejtori të Financave, i largu prej taksës kurse në pronë nuk ka shku me i tërhek ato në vitin 2016 apo 2017, me i kthyer në pronë të komunës dhe ka mbet procesi i papërfunduar dhe për neve si komision konsiderohen si kontrata jo të shkëputura. Nuk e di a është ligjore por nëse ne si asamble ia japim edhe këtë mundësi që për këtë vendim ka m'u kujdes zyra e Kryetarit bashkë me drejtorinë e pronës, besoj që ia japim mundësinë atyre që sot ekzistojnë në Z.I. dhe ushtrojnë veprimtarinë ndoshta me 100 punëtorë.

Urim Suka - pas asaj që tha Avniu unë nuk di se çka vazhdojmë me diskutu këtu kur e tha shumë qartë që ky projekt-vendim nuk ka bazë ligjore.

Flamur Bytyqi - unë e thash edhe më herët që është në dorën e Kryetarit, pa miratimin tonë për me bërë një zgjidhje. Le ti jep ky afat shtesë vet. Ti i ke 10 kontrata të shkëputura, si ke me ia vazhdu atij? Ku është baza ligjore këtu drejtor?

Nexhat Ramadani - është çështja e një vendimi që sipas gjasave është i kundërligjshëm. Ne kemi marrë plot vendime që i kthen MAPL-ja. Ajo që është konkrete, ndoshta edhe Sania e tha dhe mua më pëlqej shumë por edhe këto bisedat tona janë rekomandime se si me vepru.

Sanie Kuçi Rexhepaj - kur thojnë me marrë masa, s'pe marrim masën e vetme që ekziston me ja dhënë 1 vit kohë por ka masa të ndryshme. Unë e thashë që plani i veprimit e kategorizon secilën parcelë sepse

nuk i kemi krejt rastet e njejta. Nëse rasti kishte me qenë që nuk ka bërë as edhe një investim, për neve do t'ishte shumë e lehtë vendimi me marrë. Ka masa të ndryshme. Nëse nuk ka leje ndërtimore, i dërgon njoftim për ta legalizuar ndërtimin. Nëse ka ndërrim destinimi, i dërgon një njoftim ta legalizojë destinimin. Nëse është në fazë investive, i dërgon një njoftim, jepi një vit afat kohë. Nëse nuk ka investuar fare, kërko shkëputje të kontratës. Nëse ka borge, jepi një njoftim për përfundimin e pagesave apo dërgoje në përmbarues. Nëse funksionon një biznes tjetër dhe nuk është duke funksionu biznesi me të cilin ti ke bërë kontratë, atëherë ti duhet me kriju një zgjidhje edhe për ato raste. E tha edhe Avnia që nuk ka ndonjë bazë ligjore ky vendim për shkak se ligji e thotë qartë që Kryetari merr masa duke u bazu në raportin që e ka dorëzuar drejtoria e pronës. Ne jemi për me ndihmu, jemi për me i dhënë rekomandimet tona. Duhet me funksioni Z.I. ligjërisht mirë, sepse duke funksionu bizneset janë por ligjërisht nuk po shkojnë gjanat mirë por ne duhet me i ndihmu bizneseve edhe në këtë fazë për shkak se mendoj që bizneset e kanë shfrytëzuar neglizhencën me vetëdije që e keni bërë ju si Kryetar.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 11.

15 për, 10 kundër, Miratohet pika 11

Pika 12. Pyetje dhe përgjigje;

Vlora Kryeziu - gjatë daljeve në teren kam vërejtur disa problematika serioze në sheshin e qytetit, konkretisht vendkalime për këmbësor të bllokuar me pengesa fizike p.sh. me vazo të luleve, mungesë e vendkalimeve në zona me frekuentim të lartë të qytetarëve gjë që po i detyron qytetarët të kalojnë në mënyrë të pasigurtë. Shiritat të cilat janë të dedikuara për persona të verbër ose me dëmtim të shikimit, në disa pjesë janë të penguar me karrika, tavolina dhe pengesa tjera fizike. Për këto problematika kam dërguar dy kërkesa zyrtare në institucionet përgjegjëse komunale të shoqëruar me dokumentim dhe fotografi nga terreni. Deri më sot nuk kam marrë asnjë përgjigje zyrtare, andaj sot po e ngris këtë çështje në Kuvend sepse besoj që transparencë, përgjegjësi dhe bashkëpunimi janë themeli i punës tonë. Kërkesa ime është e qartë: dalja në teren të institucioneve përgjegjëse, të largohen pengesat nga vendkalimet dhe të shtohet numri i tyre sipas praktikave urbane, të lirohen shiritat kartil dhe domosdoshmërisht të kenë çasje në vendkalimet këmbësore në përputhje me standartet e aksesueshmërisë urbane jo të funksionojnë skaj rrugëve siq janë sot. Pres që kjo çështje të trajtohet me seriozitet dhe që së shpejti ti shohim rezultatet në teren. Qyteti ynë nuk duhet të jetë vetëm i bukur vizualisht por mbi të gjitha të jetë i sigurtë dhe i qasshëm për të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë. Vlora Kryeziu paraqet edhe dëshmitë e fotografive që i ka bërë në teren.

Visar Kuçi - nuk e kam pa kërkesën por më kanë njoftuar që ke bërë kërkesë. Për pjesën të sheshi 2 operatori ekonomik është në përfundim të punimeve dhe besoj në këtë pranverë i përmbyllin investimet dhe është fakt që nuk është e mirë gjendja sepse dikush prej lokaleve edhe e ka keqpërdorur këtë rast ku i kanë vendosur vazot apo pengesat. Sa e di unë inspektorët kanë dalë dhe i kanë gjërit.

Urim Suka - te Drejtoria e Arsimit së fundi e kam pa që është themelimi i prindërve në nivel komunal dhe dua të di që ky këshill a është bërë konform udhëzimit administrativ. Sipas asaj që kam pa unë, kam pa që nuk është transmetuar udhëzimi. Kam shqetësim për dy shkollat që janë nis nga Ministria e Arsimit, shkolla në Vranq dhe në Samadraxhë. Ka shumë vite që këto shkolla janë nis por unë dua ta di çka ka ndodhur me to. Në çfarë faze janë? A janë gati me u funksionalizuar dhe cili është roli i drejtorit? Kërkoj që ti adresoni këto pyetje te Drejtori i Arsimit. Ka shqetësime të vazhdueshme për ndriçim publik ku në shumicën e vendbanimeve ka probleme, si në Peqan, Bllacë, Suharekë, Sopijë etj. Dhe çuditërisht shpesh po rregullohen por menjëherë po prishen. Kur pritet që të funksionalizohen këto vende ku janë këto probleme. Ndërsa te fshati Bukosh është lidhur një kontratë për ndërtimin e rrugëve lokale „Zylfije Sopa dhe Qamil Kroni“, kjo shkruan në fletën e parë të kontratës por në fund të kontratës në paramasë kemi emra tjerë, p.sh. rruga „Murat Prena“ - degëzim (rruga Zelfije Krasniqi), rruga „Sahit Krasniqi“ - degëzim (rruga Idriz Bajrami), rruga „Ganimete Sopa“ - degëzim (Met Brahimi). A është ligjore që në fletën e parë me qenë emra tjerë dhe në paramasë emra tjerë? Cilat nga këto rrugë janë shtruar? A do të përsëritet një praktikë e tillë që në fletë të parë me pas emra tjerë dhe në paramasë me pas emra tjerë dhe ndoshta në teren m'u shtruar rrugë tjera?

Amir Hoxha - sa i përket ndriçimit publik, kjo që ka ndodhur deri tani ka qenë si problem i një paramase që i ka trajtuar kryesisht trupat ndriçues, poqat por jo edhe pjesën operative që e konsolidon një ndriçim publik. Ne kemi pasur një takim me punëkryesin dhe menaxherët e kontratave dhe kemi ra në përfundim që të shkëputet pjesa e kontratës me sasi të që s'janë punu, pjesët e ndriçimit të brendshëm dhe ne me inicu një procedurë tjetër për këto elemente që i ceka. Mendoj që kur të fillojmë një iniciativë të re për pjesën që nevojitet për me bërë komplet ndriçimin publik, ne duhet me bërë një fezikibilitet, me dalë në teren

dhe me i marrë të gjitha panelat elektrike, me pas një paramasë të saktë që na mundëson me pas një ndriçim të qëndrueshëm publik. Te rrugët në Bukosh unë nuk kam informacion detal mirëpo si praktikë është bërë që kur e ka kalu në prokurim emërtimin fillestar e pastaj kur janë bërë ndryshimet për degëzim, vetëm në fund të paramasës kanë mujt me pasqyru cilat rrugë janë shtrur me emërtimin e parë fillestar. Nuk e di saktësisht a është ligjore dhe nëse nuk është ligjore s'besoj që unë duhet me ndjek këtë punë. Pretendoj që në të ardhmen kur të vin këto propozime me qenë ma korrekt dhe m'u trajtu se cilat rrugë do ti shtrojmë.

Liridon Fandaj - ka 2 muaj që ju kam drejtu me një kërkesë zyrtare Drejtorit të inspeksionit dhe ende nuk kam marrë përgjigje. Kur ke me m' dhënë përgjigje sepse reagimi yt ka qenë shumë i shpejtë dhe i kundërligjshëm ditën kur një subjekt politik e ka ushtruar një aktivitet politik me lajmërim të Drejtorisë së Urbanizmit dhe ti në mënyrë të kundërligjshme dhe ata inspektorat që s'janë të asaj larmie, i ke vendos në teren. 2 muaj për me m' i dhënë informatat për bizneset dhe për hapësirat publike se kush ka leje, kjo është e papranueshme. Apo duhet me dërgu në agjencion për një mospërgjigje tënden dhe me u ndëshku komuna. Drejtoreshë e Shëndetësisë prej kur e ke marrë mandatin tash, sa herë i ke vizitu institucionet, QKMF-të dhe QMF-të nëpër fshatra dhe a janë të furnizuara me material shpenzues? po ashtu ka shqetësime nga punëtorët aty që ngrohja herë punon e herë nuk punon. A është puna e furnizimit të lëndës djegëse apo çka? Kërkoj sqarime. Te pjesa e ndriçimit ka probleme prej dhjetorit nëpër fshatra dhe një pjesë e qytetit. Pjesa e rrugës Peqan i vogël-Semetisht, a ka pranim teknik për ato punime që janë bërë sepse rruga është në një gjendje katastrofë e që çdo ditë mund të ndodh një aksident për shkak të atyre gropave që janë bërë aty. Objekti i ETC-së që është duke u ndërtuar dhe nuk ka asnjë pllakat, nuk ka njoftim. A ka leje ndërtimi dhe pse nuk e ka vendos pllakatën për lejen e ndërtimit?

Gent Gashi - Liridon është e vërtetë që ma ke dërgu emailin më 25-26 dhjetor dhe me 31 dhjetor mua më ka përfunduar mandati dhe 1 muaj nuk kam qenë drejtor. Prap e ke dërgu emailin ka 7 ditë por kemi komunikuar në tel. Dhe të kam thënë që afatet ligjore janë 7- 15 ditë. Të tregova që kemi dal në shesh, jemi duke i rishiku procedurat bashkë me Drejtorin e Urbanizmit se kush ka leje dhe kush s'ka leje pastaj me t' i dërgu të gjitha. Te pjesa ku thua ti, kam vepru.

Kimete Bajraktari - nga mandati që e kam marrë kam realizu vizita ku në QKMF ka qenë e para. E kam planin të cilin ka me realizu. Sot kam pas me shku në Studenqan dhe Duhël por nuk ka qenë mundësia për shkak të mbledhjes së Asamblesë. Sa i përket mungesës së nxemjes, kam qenë aty, e kemi diskutu por nuk është shumë problem, nuk janë pa nxemje. Është pak mungesë e naftës për shkak të mungesës së drejtorave për me i nënshkru faturat dhe për shkak se nuk është lëshu buxheti.

Amir Hoxha - nuk kam përgjigje konkrete por nëse ma dërgon me email, e marr përgjigjen në drejtori dhe kthej përgjigje.

Gent Gashi - më shumë Visari mund të na informojë ndërsa sa i përket rrethojave, është e rrethune, i ka tabelat.

Liridon Fandaj - nuk ka tabela. Ai duhet me pas të specifikune lejen e ndërtimit dhe duhet me qenë e rrethune. Shkojmë e shohim.

Flanur Bytyçi - bëhet fjalë për ndriçimin publik në rrugën Peqan i vogël-Semetisht. Është bërë një investim aty por ajo ka punuar vetëm një javë në kohën e Vitit të Ri për deri sa ekziston një kontratë 10 vjeqare mirpo fakti që më habit është, se është nënshkru kontrata në vitin 2023 në vlerë prej 2 milion euro në afat prej 10 viteve. Tash meqenëse ekziston një kontrata aktive deri në vitin 2024 në vlerë prej 109,000.00€. Të njëjtën kohë janë lidh dy kontrata dhe realisht i gjithë ky shpenzim është bërë për disa xixa. Drejtor të lus të merresh me çështjen e ndriçimit të komunës së Suharekës dhe jo vetëm në qytet por edhe nëpër fshatra. Unë kam pranuar një raport të obligimeve të rentave dhe të qerasë por nuk është cek Drejtoreshë se në cilin vit është bogji? Kur keni me marrë masa ndaj këtyre që i kanë obligim ndaj komunës? Çështja tjetër është për Drejtorinë e Shëndetësisë. Pse po mdodh që gjithmonë punëtorët shëndetësor që janë me Karitas po duhet gjithmonë m' i marrë pagat me vonesë? A mund të rregullohet kjo çështje që ata m'u ndje të barabartë me pjesën tjetër?

Amir Hoxha - edhe unë si qytetar kur kam qenë, e kam trajtu sikur ti këtë pjesë mirëpo kur e kam pa paramasën dhe kontratën siq ka qenë, sinjerisht të them se aty në kontratë ka më shumë të specifikuar sasi të trupave ndriçues dhe në kontratë nuk ka sasi të mjaftueshme për suplemente tjera që e bëjnë një ndriçim publik të qëndrueshëm. Kemi pas dy takime të menaxherave dhe të punëkrësve dhe tani jemi në përfundim të mbylljes së kontratës ku e kemi anuluar pjesën e ndriçimit përbrenda shkollave pasi shkollat tani mbajnë mësim në një ndërrim dhe nuk kemi nevojë për atë sasi të konsiderueshme të ndriçimit. E ndërprejmë kontratën me 70% të realizuar dhe me fillu me inicu një tjetër për stabilimentet tjera që e bëjnë një ndriçim të qëndrueshëm. Kjo është brengë e gjithë neve dhe jemi duke u marrë seriozisht me këtë punë dhe jam i hapur për të gjithë ju që të vini të konsultoheni për gjithëçka, për me bërë një inicim të ri.

Sanie Kuçi Rexhepaj - është shumë shqetësuese pjesa e ndriçimit.Një kontratë mbi 2.5 milion euro që është nënshkruar që nga viti 2023,tash kemi ardhë në një pikë që ju paskët rekomandu shkëputjen e kontratës.Për çfarë arsye po bëhet shkëputja e kontratës në këtë fazë?A është vetëm sipas kërkesave të operatorit ekonomikë që ndoshta i ka plotësuar elementet të cilat i kanë konvenu me çmim ma të favorshëm dhe pjesa tjetër nuk po i përhtatet për me zbatu në teren për shkak se kemi shumë problematika në teren që nuk ka pas reagim nga ana e kompanisë.A mendoni që është zgjidhja e duhur e shkëputjes së kontratës në këtë pikë apo ndoshta u desh një rishqyrtim tjetër dhe zbatim i kontratës në bazë të paramasës dhe parallogarisë që e keni pas?

Amir Hoxha - Punëkryesi është i interesuar me plotësu komplet kontratën por ne nuk mendoj që kemi interes me shpenzu për ato drita për ambiente të brendshme,për shkolla dhe institucione tjera komunale për shkak se neve po na intereson me shkëput që me na mbet diçka prej kësaj sasive të fondeve për me inicu një kontratë të re për ato pjesë që i ceka më lart.Me pas qenë paramasë më në detale që e kompletton ndriçimin publik,ne nuk kishim ardhë deri te kjo pikë.

Sanie Kuçi Rexhepaj - të përgëzoj për analizim që je duke e bërë.Si sugjerim meqenëse sa e ke marrë detyrën.Të gjitha fazat e zhvillimit të një projekti duhet qysh në fazën e parë të planifikimit me u marrë parasysh dhe jo me ardhë puna në këtë pikë dhe me thanë që në këto pozicione i paskemi parapa gabim e na duhen tjera pozicione.

Flamur Bytyçi - meqenëse po pretendoni që do të shkëputet kontrata,cila është zgjidhja që ka me rregullu atë ndriçim,p.sh. që është bënë në Semetisht ose në qytet?A keni me bo një kontratë të re?A keni me ndëshku operatorin i cili e ka një kontratë 10 vjet?

Amir Hoxha - operatori ka 10 vjet garancion për trupa ndriçues.Dritat janë shumë të mira dhe këto i njoh si profesionist i fushës.Ai në paramasë këtë punë që e ka bënë e ka pas.Është problem që paramasa ka pas defekte siq po thotë Sania në fillim që nuk ka pas edhe elemente tjera përbërëse të ndriçimit publik.Ne tash pretendojmë në hapa të ardhshme që kur ta mbyllim këtë kontratë me marrëveshje dypalëshe,me inicu një kontratë tjetër për të gjitha nevojat imediate që e bëjnë një ndriçim të qëndrueshëm publik.

Urim Suka - unë pak e kam pa këtë kontratën.Me sa di unë kontrata është bënë me qëllim që një investitor privat me investu asete të veta,me i ndërru poqet ndriçues me qëllim që me shpenzu rrymë më pak,komuna pastaj për atë investim që ai e bën,përfiton te shpenzimet e rrymës dhe për shkak që atje shpenzon më pak,prej atyre mjeteve me i bënë pagesë atij.Në plan të parë m'u ka dok mirë por gjatë rrugës kam pa që ato drita që ai i ka ndërru i ka me një çmim shumë të madh dhe në një formë u dëmtu edhe buxheti i komunës.A ka komuna një lloj raporti se sa ka investu operatori ekonomikë dhe sa ka pagu komuna kundrejt investimit që ka bënë operatori ekonomikë?Nëse e ndërpreu kontratën,a dëmtohet garancioni apo vazhdon me ekzistuar garancioni për ato që janë vendos?

Visar Kuçi - operatori ekonomikë kur ka ofertu e ka sjell një plan të fezibilitetit për me i zvogëlu shpenzimet.E kemi pas një problem sepse në ofertë kanë qenë p.sh. 3900 drita publike por kur ka dal me bo planin e fezibilitetit kanë dal 4900.Dritat të jashtme ka pas nevojë më shumë se që ka pas në kontratë.Kur e ka bo planin e fezibilitetit i ka bo edhe të gjitha shkollave.Ne nuk kemi pas nevojë me i ndërru dritat nëpër shkolla që e mbajnë një ndërrim.Kontrata nuk ka me shkëput por ka me u mbyll në këtë fazë pa u përmbush 100%,ashtu jemi pajtu dy palët.Në kontratën që e ka operatori ekonomikë për punën që e ka kry,pagesat i bëhen për 10 vite.83,000.00 ka pagu garancione për pozicionet që i ka montu.Konrata po përmbillet në këtë fazë për sasi kurse kontrata mbetet aktive për garancion deri në 10 vite.

Urim Suka - llampa ndriçuese që janë vendos sipas çmimit të tregut janë shumëfish më të shtrenjta.A qëndrojnë këto?A u dëmtu interesi i komunës?Sa ka investu dhe sa ka pagu komuna?

Amir Hoxha - raportin mund ta jap me shkrim.Çmimi i lampës nuk kalkulohet vetëm si çmim me shku me ble n'dyqan por llogaritet montimi dhe mirëmbajtja për 10 vite.

Erëza Ramadani - listën që ma ke kërku në KPF,e kam kërku prej zyrtarëve dhe ta kam sjell sot.Borgjet janë të akumuluar ndër vite.Jam njoftu nga zyrtarët që janë marrë masa për shumicën që janë në listë.Nëse don diçka më hollësisht mundesh me u drejtu me email dhe përgjigjem seancën tjetër.

Jehona Rrafshi Lumi - shqetësimi im është për disa shenja të komunikacionit të cilat gjinden në fshatin Bllacë.Aktualisht këto shenja janë të vendosura te varrezat e fshatit Bllacë ku këto shenja shënojnë kujdes shkolla e realisht shkolla gjindet 3 km larg shenjës së vendosur.Njëjtë është edhe tek hyrja e Bajraktarëve ndërsa në afërsi të shkollës,as 200 m afër nuk ka shenjë kujdes shkolla.Kërkoj sqarime nga Drejtori i Urbanizmit dhe kërkoj që këto shenja të jenë të vendosuar më afër shkollës.

Visar Kuçi - më duket që një operator ekonomikë që është i kontraktuar nga ministria i ka vendos këto shenja.Nëse i ka vendos keq,ne e kemi inspektoriatin,dalim edhe i heqim sepse kemi disa raste.

Dardan Berisha - kam një pyetje konkretisht prej prindërve. Në shkollën 7 Marsi 3 klasa të II-ta mësimin e fillojnë në 08:30 por mësimi në 7 Mars fillon në 07:40. Prindërit kanë problem sepse duhet me qenë në punë në ora 8 por duhet me i prit fëmijët. Ju lus ta ngrisni këtë shqetësim te drejtori i Arsimit. Pse ky ndryshim i orarit ku po paraqet probleme te prindërit të cilët punojnë nëpër institucione dhe nuk mundën me arrit kohën për me m'rri n'punë.

Nënkryetarja - pyetjen do t'ia përcjell drejtorit por meqë kam punu në atë shkollë po ta jap përgjigjen. 7 Marsi punon me dy ndërrime ku cilki 6 deri 9 punon paradite. Vetëm klasat e para që kanë filluar vitin e kaluar, me kërkesë të prindërve dhe për shkak se neve po na zvogëlohet numri i nxënësve sepse prindërit i qojnë fëmijët në shkollën „Destan Bajraktari“ vetëm për shkak të ndërrimit.

Mësimi fillon në 07:40 me ja mundësu të dy ndërrimeve që edhe ata të pasdites kur e kryejnë në 05:25 me qenë një kohë e përshtatshme me i marë prindërit. Me këshillin drejtues të shkollës e kanë vendos që klasat e II-ta me fillu në 08:30, në orën e dytë të mësimit që prindërit ti marrin në 12:05 kur është koha e pauzës.

Dardan Berisha - unë mendoj që më e arsyeshme është me u respektu orari i fillimit se sa orari i mbarimit. Ky është një lëshim i drejtorit të shkollës dha ka mundësi që Drejtori i Arsimit nuk e din. Ky shqetësim është i disa prindërve të cilët punojnë edhe në komunë.

Takimi përfundoi: 15:40

Procesmbajtësja: Dafina Haziraj

Kryesuesi i Kuvendit

Mr. ec Bexhet Kuçi